


# FACE



**FORCOJMË VETËBESIMIN  
DHE PUNOJMË SË BASHKU**



FACE - Familjet dhe fëmijët në arsim është projekt i bashkëfinancuar nga Universiteti i Cyrihut për përgatitjen e mësuesve (Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut) dhe nga Departamenti i Financave i Kantonit të Cyrihut, Zvicër.

Forcojmë vetëbesimin dhe punojmë së bashku. Material trajnues për mësues.

Autore: Wiltrud Weidinger  
Ilustrimet dhe faqosja: Nadine Hugli  
Zyra e botimit: Franziska Agosti




Publikuar më 2017  
Universiteti i Cyrihut për përgatitjen e mësuesve, Qendra IPE  
[www.phzh.ch/ipe](http://www.phzh.ch/ipe)

# FACE

Wiltrud Weidinger

## **FORCOJMË VETËBESIMIN DHE PUNOJMË SË BASHKU**

**Material trajnues për mësues**



## Si të punojmë me këtë libër?

Mirë se vini në FACE – Familjet dhe fëmijët në arsim – Forcojmë vetëbesimin dhe punojmë së bashku!

Ky libër ju përket juve si mësues. Është libër pune për ju, i cili shërben gjatë trajnimit në programin FACE. Në këtë libër, do të gjeni:

- informata mbi programin FACE,
- aspektet kryesore psikologjike dhe pedagogjike të FACE,
- aktivitete për ju që t'i përfundoni.


Disa aktivitete janë të parapara për punë apo studim individual; të tjerat kërkojnë bashkëpunim apo shkëmbim të përvojave me kolegët. Materiali trajnues FACE ju udhëzon përmes temave të ndryshme në kapituj të ndryshëm. Ai përfshin informata hyrëse mbi tema të ndryshme në trajtën e artikujve apo përmbledhjeve të shkurtra. Të gjitha detyrat kërkojnë një lloj aktiviteti nga ana juaj. Nëpër artikuj ju do të gjeni mjaft hapësirë për të shkruar. Nga trajneri juaj do të merrni udhëzime se si t'i kryeni detyrat.

Ju urojmë një kurs trajnimi interesant dhe shumë sukses në mësimdhënien e FACE!



## Përmbajtja




<b>1</b>	<b>FACE – programi</b>	<b>5</b>
1.1	Hyrje e përgjithshme: FACE – programi	5
1.2	Organizimi i FACE	9
1.3	Kompetencat në FACE	11
<b>2</b>	<b>Prapavija psikologjike</b>	<b>15</b>
2.1	Çfarë është koncepti për veten? Një listë kontrolluese për mësuesit	15
2.2	Shkathtësitë për jetën	18
2.3	Shpërfaqja e kompetencave ekzistuese	20
<b>3</b>	<b>Prapavija pedagogjike</b>	<b>23</b>
3.1	Një perspektivë drejt mësimdhënies dhe të nxënit	23
3.2	Të nxënit relevant për jetën	26
3.3	Rolet e ndryshme të nxënësve dhe mësuesve	28
<b>4</b>	<b>Metodat didaktike</b>	<b>31</b>
4.1	Të nxënit e bazuar në detyra	31
4.2	Të nxënit bashkëpunues	33
4.3	Orientimi në qëllim	35
4.4	Diferencimi dhe llojshmëria e detyrave	36
<b>5</b>	<b>Vlerësimi i proceseve mësimore</b>	<b>39</b>
5.1	Perspektivat e vlerësimit	39
5.2	Format e vlerësimit	40
5.3	Normat e vlerësimit	43
5.4	Dhënia e informacionit kthyes nxënësve: prej ligjëruesit në lehtësues	44
5.5	Dhënia e informacionit kthyes prindërve	46



# 1 FACE – PROGRAMI

## 1.1 Hyrje e përgjithshme: FACE – programi

FACE – Familjet dhe fëmijët në arsim përfshin një seri të materialeve mësimore. Seria FACE u hartua për të përkrahur fëmijët në zhvillimin e konceptit për veten dhe të pikëpamjes për kompetencat, talentet dhe interesat e tyre. Materiali mësimor për vetëbesim FACE është i ndarë në tri nivele të ndryshme:

-  Moshë 4-6: FACE 1 – Forcojmë vetëbesimin dhe luajmë së bashku
-  Moshë 7-9: FACE 2 – Forcojmë vetëbesimin dhe festojmë së bashku
-  Moshë 10-12: FACE 3 – Forcojmë vetëbesimin dhe punojmë së bashku

### Struktura

Të gjitha pjesët e serisë FACE janë ndërtuar në të njëjtën mënyrë. Librat përbëhen nga 6 tema kryesore dhe secila merret me nivelet e ndryshme të zhvillimit të konceptit për veten dhe kompetencave vetanake të fëmijëve dhe të rinjve. Me secilën temë janë adresuar dy perspektiva: ajo e vetë nxënësit dhe ajo e të tjerëve përreth tij/saj. Kalimi në mes të këtyre dy perspektivave është pjesë e secilës temë, për t'u ndihmuar fëmijëve të zhvillojnë shkathtësinë për të përfunduar përvojën e perceptimit mbi veten me përvojën e të përceptuarit nga të tjerët.

Çdo libër i FACE mbaron me një temë reflektimi mbi procesin e të mësuarit nga nxënësi (kapitulli 7). Faqja e fundit i jep mësuesit apo edukatorit hapësirë për t'i dhënë secilit nxënës informatën kthyesë personale. Ne rekomandojmë fuqishëm që mësuesit dhe edukatorët të shfrytëzojnë mundësinë e dhënies së informatave kthyesë konstruktive, në vend se të bëjnë thjesht një vlerësim me notë.

Secila detyrë fillon me një faqe të informatave e udhëzimeve që përshkruajnë qëllimet, mënyrën e organizimit të mësimin, si dhe hapat kryesorë të mësimin dhe materialin e nevojshëm. Kjo faqe u dedikohet mësuesve dhe edukatorëve. Disa detyra po ashtu përfshijnë mundësi për variacion. Pas faqes me informata, është renditur materiali i punës për nxënës. Kjo faqe apo këto faqe u dedikohen nxënësve për të punuar.

Secila temë përbëhet prej 6 detyrave dhe secila prej tyre zgjat rreth 30-60 minuta, në varësi të nivelit të grupit. Detyra 5 është gjithmonë detyrë që fëmijët duhet ta kryejnë në shtëpi. Prindërit e tyre, vëllezërit, motrat apo anëtarët tjerë të familjes janë të nevojshëm për të ofruar informata apo opinione, të cilat nxënësit i regjistrojnë. Në fund të programit vjetor të FACE, organizohet një ekspozitë apo ngjarje (festim) me pjesëmarrjen e prindërve. Qëllimi i saj është të tregohen dhe të festohen rezultatet dhe produktet që nxënësit i kanë nxjerrë gjatë punës së tyre në programin FACE.

### Kjo pasqyrë tregon strukturën e FACE – Forcojmë vetëbesimin dhe punojmë së bashku:

Kapitujt	Detyrat	Përmbajtja
1-6: Tema	1-4	Në shkollë
	5	Në shtëpi
	6/7	Reflektim në shkollë mbi detyrën e shtëpisë
7: Reflektim	1-4	Reflektim mbi proceset mësimore për t'u zgjidhur në shkollë
		Përshtypjet me shkrim nga mësuesi

### Përmbajtja

Për të përkrahur zhvillimin e konceptit për veten, kompetencës vetanake dhe vetëbesimit librat e FACE përmbajnë tema të ndryshme. Temat e përfshira në FACE mbulojnë fushat në vijim:

- Për veten
- Familja ime dhe unë
- Shokët e mi
- Vendet e mia të preferuara
- Çfarë mund të bëj – shkathtësitë e mia
- Ndjenjat e mia
- Si i zgjidh konfliktet

Secila temë u qaset pyetjeve prej perspektivës së individit dhe po ashtu transformohet duke marrë perspektivën e personit tjetër. Nxënësit duhet të punojnë së bashku të shumtën e kohës. Në detyrën 5 të secilit kapitull, nxënësit i marrin në familjet e tyre pyetjet e shtruar dhe kërkojnë kontributin dhe mendimet e familjes. Secili libër i FACE fokusohet në një produkt të veçantë që arrihet nga nxënësit, mësuesit dhe prindërit: FACE 1 (të luajturit së bashku në një festë lojërash), FACE 2 (një festim i përbashkët) dhe FACE 3 (përgatitja e një ekspozite).



Kur shikohet në përmbajtjet e librave FACE, është e qartë se shumica përputhen me lëndët si studime shoqërore apo gjuhë. Kur shikohet në kompetencat që kërkohen në kapituj dhe detyra të ndryshme, lëndët si matematika, artet, punë dore, historia, gjeografia apo biologjia mund të përfshihen dhe të mbulohen.

### Adaptimi kulturor

Seria FACE është përpiluar dhe krijuar nga ekspertët e Universitetit të Cyrihut për Përgatitjen e Mësuesve, për përdorim në kontekste të ndryshme mësimore anë e mbanë botës. Prandaj, shumica e detyrave janë hartuar ashtu që të jenë "përfshirëse në aspektin kulturor", që do të thotë se mund të përdoren me fëmijët e moshave të caktuara, kudo në botë. Megjithatë, secila temë po ashtu përfshin një apo dy detyra që mund t'i adaptohen kontekstit specifik në të cilin përdoret materiali. Këto detyra shpesh përqendrohen në çështje specifike kulturore të një grupi të caktuar pakicë (p.sh. fëmijët e rrugës, fëmijët refugjatë, pakicat etnike, etj.). Burime të ndryshme janë shfrytëzuar për të përpiluar serinë FACE, disa nga to në formën origjinale, e shumica i janë përshtatur kontekstit të këtij libri. Në këto raste kjo tregohet me referencën e materialit poshtë secilës detyrë apo poshtë materialit punues për nxënësit.

### Rolet e ndryshme

#### Cilat janë rolet e nxënësve?

Nxënësit janë aktorët kryesorë në programin FACE. Ata, si nxënës, kanë ndikimin më të madh në rezultat dhe suksesin e tyre. Lënda nuk u jepet atyre: ATA duhet ta marrin atë! Ata do të mësojnë, të shkruajnë, të vizatojnë, të realizojnë intervista dhe të kontaktojnë njerëz – në një mënyrë të përshtatshme për moshën e tyre. Materiali mësimor është hartuar në mënyrë të tillë për të nxitur të mësuarit aktiv te nxënësit dhe për t'i bërë ata përgjegjës për proceset e të mësuarit. FACE po ashtu u kërkon nxënësve të planifikojnë dhe të vlerësojnë të mësuarit të tyre, duke e zhvilluar dhe ushtruar metakognicionin si strategji të të mësuarit.

#### Cili është roli i prindërve të nxënësve?


Prindërit e nxënësve i mbështesin ata në rrugën e tyre përgjatë jetës shkollë. Ata e bëjnë këtë kryesisht duke qenë të interesuar në atë që bëjnë nxënësit, duke ndarë kohë për të diskutuar çështje të ndryshme me ta, duke i dëgjuar ata, duke u ofruar atyre informatat që u duhen apo materialin që duhet ta marrin me vete në shkollë (p.sh. fotografi).

#### Cili është roli i mësuesit?

Është roli i mësuesit që të nxisë të mësuarit aktiv te nxënësit dhe të mësuarit vetanë si mësimdhënës. Në vend të ligjërimit, mësuesi do të marrë rolin e lehtësuesit dhe udhëheqësit që mbështet nxënësit në proceset e tyre të të mësuarit. Sidoqoftë, mësuesi prapëseprapë e mban përgjegjësinë për të orientuar proceset e të mësuarit, për t'u dhënë nxënësve informata kthyesë për rezultatet dhe produktet e tyre, dhe, në fund, për ta vlerësuar punën e tyre.

Tri idetë themelore të programit FACE sipas këndvështrimit tim janë:

1.
2.
3.



## 1.2 Organizimi i FACE

### Detyrë:

1. Lexoni tekstin e shkurtër në faqen në vijim.
2. Mendoni për orarin e mësimdhënies suaj. A mund të përshtatet diku FACE? Kjo do të jetë e ndryshme për mësuesit klasorë dhe mësuesit lëndorë.
3. Plotësojeni orarin e tashëm të mësimdhënies dhe shkruani se ku mund të integrohet FACE.
4. Shënoni dy pyetje dhe bëni ato pyetje në gjithë grupin.

Është detyra e mësuesit apo edukatorit që të vendosë së si do të organizojë mësimdhënien e FACE. Kjo mund të bëhet në një mënyrë të integruar për t'iu përshtatur orëve të zakonshme të mësimi të grupit (p.sh ofrimi i FACE për një gjysmë ore brenda ditës apo javës). Po ashtu mund të bëhet në formë të një blloku të orarit më konciz (p.sh. ofrimi i FACE gjatë blloqeve më të mëdha kohore të shpërndara përgjatë dy javëve të njëpasnjëshme). Ne rekomandojmë përdorimin rregullisht të FACE që fëmijët ta provojnë vazhdimësinë përgjatë një periudhe më të gjatë kohore. Kjo do të lejojë që librat FACE të bëhen vegla më të njohura dhe më të përdorshme për nxënësit.

### Orari im i tashëm i mësimdhënies:

	E hënë	E martë	E mërkurë	E enjte	E premte
08 – 09					
09 – 10					
10 – 11					
11 – 12					
13 – 14					
14 – 15					
15 – 16					
16 – 17					
17 – 18					
18 – 19					
19 – 20					

Mendoni për orarin tuaj dhe shkruani se ku mund të integroni FACE në mësimdhënien tuaj (p.sh. në sekuenca 30 minutëshe, apo në blloqe fikse prej 1 apo 2 orëve në javë?). Merrni parasysh se me FACE ju po ashtu mund të mbuloni lëndët shoqërore, gjuhët, artet, etj.

**Shkruani dy pyetje për t'i bërë në grup:**

1.
2.



## 1.3 Kompetencat në FACE

### Detyrë:

1. Uluni në grup prej 4 vetave.
2. Lexoni tekstin mbi kompetencat në faqen në vijim.
3. Shkruani kompetencat kryesore që FACE i promovon.
4. Zgjedhni tri kompetenca prej listës së kompetencave.
5. Shfletoni librin. Përpiquni të gjeni një detyrë që nxit një kompetencë.  
Shkruani cilat detyra nxisin cilat kompetenca.
6. Shkëmbeni rezultatet e juaja me anëtarët e tjerë të grupit.

Mësimdhënia dhe të nxënit në klasa shumëkulturore dhe shumëetnike duhet të jetë e bazuar në kompetenca në mënyrë që ta lë pas pedagogjinë deficitare. Shkenca mësimore ka prodhuar përkufizime të ndryshme të çdo gjëje që i përket "kompetencave". Përkufizimi i përdorur më së shumti në vendet gjermanofolëse është ai i Franz E. Weinert: "Kompetencat janë aftësitë njohëse në dispozicion të individëve ose të fituara prej tyre për të zgjidhur problemet specifike, si dhe gatishmëria motivuese, e vullnetshme (përcaktuar nga vullneti) dhe sociale, e edhe shkathtësitë e lidhura me to për të aplikuar zgjidhjen e problemeve me sukses dhe me përgjegjësi në situata të ndryshme" (Weinert 2001). Kjo nuk ka të bëjë me dijen faktike por më shumë me shkathtësinë për të zgjidhur problem dhe, përfundimisht, me qëndrimet dhe motivimin e nevojshëm. Metodologjia e mësimdhënies veçon dy lloje të kompetencave: kompetencat specifike të lëndëve dhe kompetencat e transferueshme. Kompetencat specifike të lëndëve janë të gjitha aftësitë e lidhura ngushtë me një lëndë të veçantë shkollore. Kompetencat e transferueshme janë të gjitha ato shkathtësi të nevojshme për të qenë në gjendje të përballemi në jetë dhe që nuk lidhen me ndonjë lëndë të veçantë shkollore. Këto mund të jenë, për shembull, kompetencat personale (vetëbesimi, reflektimi, etj.), sociale shkathtësitë e bashkëpunimit, shkathtësitë e zgjidhjes së konflikteve, etj.), por edhe ato metodike (shkathtësitë e komunikimit, shkathtësitë e zgjidhjes së problemeve, etj.).

Shkurt, kjo do të thotë:

- Qëllimet që duhet të arrihen nga nxënësit përbëjnë fusha ose nivele të ndryshme të kompetencave. Të mësuarit në shkollë nuk udhëhiqet më nga një gamë specifike e temave ose nga qëllimet specifike të përmbajtjes që duhet të arrihen, por nga një sërë kompetencash që duhet të fitohen nga nxënësit hap pas hapi.
- Aftësia dhe përparimi i nxënësve vlerësohen në bazë të arritjes së tyre (ose "performancës" si quhet më shpesh) në lidhje me një nivel të veçantë të kompetencës.

Insistimi në mësimin e bazuar në kompetenca shkon krah për krah me kërkesën për arsimim me nxënësin në qendër dhe të orientuar në nevoja. Si përmbledhje, mund të thuhet se mësimi i bazuar në kompetenca karakterizohet nga këto aspekte/procedura/metoda të punës:

- Aktivizimi i aftësive njohëse të nxënësve duke përdorur ushtrime me kërkesa të larta, por mirë të përshtatura
- Vendosja e lidhjes mes njohurive dhe aftësive ekzistuese dhe përmbajtjes së sapofituar
- Të praktikuarit inteligjent
- Kërkimi i situatave të përshtatshme për të aplikuar njohuritë dhe aftësitë
- Mbështetja individuale e proceseve mësimore
- Reflektimi i nxënësve mbi përparimin e të nxënësve të tyre (metakognicioni)

### **Kompetencat dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës**

Në debatin akademik, orientimi në kompetenca po ashtu lidhet shpesh me konceptin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe me fitimin në shkollë të shkathtësive të përshtatshme për jetën. Kjo tendencë mund të gjurmohet edhe në dokumentet e botuara nga Komisioni Evropian: "Është vendi ku i fitojnë njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat bazë që u nevojiten përgjatë jetës së tyre dhe vendi ku zhvillohen shumë nga qëndrimet dhe vlerat e tyre themelore" (Komisioni Evropian 2010). Si rezultat i kësaj, është rritur kërkesa për mësuesit që të jenë të pajisur me kompetencat e nevojshme për të orientuar të mësuarit e nxënësve të tyre drejt një perspektive tërëjetësore.


Ato kompetenca që janë të lidhura me kërkesat e të mësuarit gjatë gjithë jetës kanë të bëjnë me fushat si: motivimi i të mësuarit, sigurimi i vetëefikasitetit, shkathtësitë e punës në grup, kompetenca e informacionit dhe e hulumtimit, fleksibiliteti, kompetenca e komunikimit, etj. Materialet e zhvilluara për mësimin e FACEi ndihmojnë fëmijët dhe të rinjtë për të zbuluar dhe për t'u bërë të vetëdijshëm për kompetencat e tyre ekzistuese. Më tutje, materialet synojnë të shtyjnë tutje konceptin për veten dhe vetëvlerësimin e nxënësve, punën e tyre në bashkëpunim me njëri-tjetrin, zhvillimin e kulturës së shëndoshë të të mësuarit nga gabimet, motivimin e brendshëm për të mësuarit e vetëdrejtuar, kompetencën e vlerësimit të të mësuarit të tyre sikurse edhe kompetencën e të qenit në gjendje për të marrë vendime dhe për të bartur pasojat e këtyre vendimeve. Në një përshkrim më të detajuar të zhvillimit të mëtutjeshëm të konceptit për veten dhe shkathtësive jetësore, fushat e kompetencave në vijim janë kyçe:

- kompetenca analitike e fuqive dhe dobësive personale
- kompetenca metodologjike për t'iu qasur informacionit dhe për të zhvilluar strategji të të mësuarit
- kompetenca e zgjidhjes së konflikteve
- kompetenca e komunikimit dhe kompetenca e bashkëpunimit
- kompetenca e vendimmarrjes dhe marrjes së përgjegjësive

Në këtë kuptim, "kompetenca analitike" ka për qëllim të merret me aftësitë vetanake të dikujt përmes një qasjeje të orientuar në kompetenca (në vend të asaj të orientuar në mangësi), t'i gjejë dhe t'i rendisë, t'i peshojë ato dhe, pas vënies së tyre në përdorim, t'i vlerësojë ato. "Kompetenca metodologjike" përshkruan zotërimin e një varg metodash e teknikash të ndryshme që mundësojnë vetëreflektimin dhe shkathtësinë për t'u futur në dialog me homologun. Kjo përfshin metodat si shkruarja e listave, argumentimi "për" dhe "kundër", të qenit i/e aftë për të paraqitur rrethanat reale (p.sh. të shprehurit e ndjenjave), bërja e intervistave, dhënia dhe marrja e informatave kthyesë, të imagjinuarit e situatave "çka nëse", gjetja e zgjidhjeve alternative për një problem të dhënë, etj.

Kjo fushë e kompetencave përfshin një gamë të tërë të strategjive të të mësuarit, përveç zhvillimit dhe përmirësimit të strategjive të veçanta të të mësuarit që janë treguar të jenë më efektive për një individ të caktuar. Metodot e fituara, në fund të fundit, shërbejnë për të gjetur një kuptim më të thellë të shprehive të punës dhe modeleve të të menduarit të aktivizuara për të kapërcyer sfidat e jetës. Fusha e "kompetencës së zgjidhjes së konflikteve" është dëshmuar të jetë shumë kuptimplote, sidomos nëse projekti kërkon të angazhojë grupe shumë të pafavorizuara dhe të stigmatizuara. Shembulli i fëmijëve romë në Rumani tregon se përvetësimi i strategjive jo të dhunshme të zgjidhjes së konflikteve është i domosdoshëm për jetën e përbashkët. Me këtë është shpresuar që këta fëmijë dhe të rinj të jenë ndihmuar drejt krijimit të një jete në paqe. Fusha e "kompetencës së komunikimit dhe bashkëpunimit" ka për cak komunikimin e përshtatshëm për moshën, komunikimin me respekt, shprehjen e opinioneve, formulimin e nevojave, aftësinë për të dëgjuar dhe për t'u përgjigjur, sikurse edhe të gjitha format e bashkëpunimit në çift, por edhe në grup. Në këtë mënyrë, nxënësit duhet të përgatiten jo vetëm për sfidat e arsimit të lartë dhe të mëtutjeshëm, por po ashtu edhe për ato që paraqiten në botën e punës. Përfundimisht, "Kompetenca e vendimmarrjes dhe marrja e përgjegjësisë" përshkruan fushën e kompetencës në të cilën nxënësit janë në gjendje të marrin vendimet e tyre të para lidhur me interesat e tyre, të marrin përgjegjësi për ato vendime dhe t'i mbrojnë ato. Kjo bëhet gjithnjë e më e rëndësishme, ndërsa nxënësit i afrohen fazës së kalimit prej shkollës në punë.

Kompetencat	Detyrat në FACE
1.	
2.	
3.	





## 2 PRAPAVIJA PSIKOLOGJIKE

### 2.1 Çfarë është koncepti për veten? Një listë kontrolluese për mësuesit.

#### Detyrë:

1. Mendoni për atë që ju e lidhni me konceptin për veten. Mendoni për nxënësit tuaj në një të klasë. Ndoshta doni ta shihni listën e nxënësve të klasës për t'ju ndihmuar me këtë.
2. Cilët prej këtyre nxënësve kanë koncept pozitiv për veten, sipas këndvështrimit tuaj? Shkruani emrat e tyre.
3. Lexoni tekstin në faqen në vijim.
4. Shikoni shënimet tuaja sërish. A e keni akoma të njëjtin mendim?  
Nëse po, bëni një shenjë ✓.

Nxënësit me koncept pozitiv për veten:

Emri i nxënësit	Po apo jo?



### **Koncepti për veten**

Koncepti për veten në kontekstin e FACE e ndjek idenë e përgjithshme të konceptit për veten si "njohuritë dhe bindjet e individëve për veten – idetë, ndjenjat, qëndrimet dhe pritjet e tyre". Koncepti për veten, sikur kuptohet në këtë kontekst, mund të ndahet tutje në disa kategori. Ose mund të ndjekë edhe nëndarjet më të detajuara si fushat joakademike (si paraqitja fizike, popullariteti, besueshmëria, marrëdhëniet me prindërit, qëndrueshmëria emocionale) ose fushat akademike (oratoria, matematika, zgjidhja e problemeve, arti etj.). Prandaj koncepti për veten është i lidhur ngushtë me arritjet dhe vetëvlerësimin. Megjithatë, koncepti për veten mund të përshkruhet si një strukturë kognitive, një besim rreth asaj se kush je. Vetëvlerësimi (apo respekti për veten) është më shumë një ndjenjë e përgjithshme e vlerës së vetes që përfshin konceptet për veten në të gjitha fushat e jetës. Në kontekstin e programit FACE, ne e përdorim termin dhe modelin e konceptit për veten. Vetëvlerësimi është po ashtu shumë i ndikuar nga kultura që e rrethon personin dhe nga ajo se si kjo kulturë i vlerëson karakteristikat e caktuara të personit. Ky ndikim kulturor është i komplikuar kur fëmijët rriten në rrethana të vështira socio-ekonomike që i detyrojnë familjet dhe fëmijët të luftojnë për mbijetesën e tyre.

Më fjalë tjera, koncepti për veten do të thotë se si ndihemi ne për veten. Për një fëmijë apo të ri kjo mund të thotë se si dhe deri në ç'masë ai/ajo ndihet i vlerësuar nga familja e tij/saj, si ai/ajo ndihet si nxënës, si ai/ajo ndihet se mësuesit dhe nxënësit e tjerë e perceptojnë atë, si e shoh veten si shok apo shoqe, etj. Koncepti për veten gjithashtu përfshin masën në të cilën fëmijët mendojnë se pranojnë nga miqtë e tyre dhe nëse ata besojnë në kompetencat e tyre për ta zotëruar jetën e tyre. Koncepti pozitiv për veten është vendimtar për përmbushjen e fëmijëve e të rinjve, për mirëqenien e tyre sociale dhe emocionale, sikurse edhe për arritjet akademike. Fëmijët dhe të rinjtë me ndjenja negative për veten janë të prirur gjithashtu për ndjenja negative ndaj të tjerëve. Ata kanë tendencë të kenë arritje të ulëta akademike dhe janë më të prirur ndaj problemeve me sjelljen. Fëmijëria dhe adoleshenca e hershme janë periudha për ta përkrahur konceptin pozitiv për veten. Sa më i rritur që të bëhet fëmija, aq më e vështirë do të bëhet të eliminohen efektet e konceptit negativ për veten. Sidoqoftë, është e mundur që të ekzistojë një koncept shumë i ulët dhe negativ për veten në fusha të caktuara, pa pasur ndonjë ndikim në fusha të tjera. Gjithashtu, fuqia e konceptit për veten mund të ndryshojë me

kalimin e kohës. Fëmijët që ndihen "ndryshe" kanë tendencë të zhvillojnë koncept negativ për veten. Është shumë me rëndësi të mbështeten fëmijët në zhvillimin e një koncepti të ekuilibruar për veten. Njohja e anëve të forta të tyre dhe vlerësimi i tyre do t'i lejojë nxënësit që në të njëjtën kohë të shohin edhe kufizimet e tyre. Nxënësit duhet të mësojnë të kuptojnë se nuk mund të jenë të përsosur, sepse askush nuk është. Përsosmëria është një qëllim joreal. Kushdo që përpiqet të bëhet i përsosur do të përfundojë i palumtur. Qëllimi i nxënësve duhet të jetë të përpiqen për më të mirën. Mbështetja e konceptit për veten të nxënësit është e lidhur me kompetenca të caktuara.

### **Kriteret për vëzhgimin e sjelljes që lidhet me konceptin për veten**

Është e mundshme të vëzhgohet dhe vlerësohet koncepti për veten i nxënësve përgjatë një periudhe të caktuar kohore. Si mësues, ju mund të bëni pyetjet në vijim si kriteret për të vlerësuar konceptin e tyre për veten:

#### **Listë kontrolluese për mësues:**

- 
- A janë nxënësit të gatshëm të marrin rezikun e të bërit gabim në punën apo lojën e tyre?
  - A kanë ata vetëbesim të mjaftueshëm për të folur në klasë?
  - A janë ata të etur për përvoja të reja dhe a ndërmarrin sfida të reja?
  - A mund të krijojnë miqësi?
  - A mund të caktojnë objektiva për vetveten?
  - A u përgjigjen ata kërkesave të mësuesit?
  - A janë pritjet e tyre prej vetes realiste?
  - A mund të pranojnë ata dështimet?
  - A janë ata të gatshëm të mësojnë prej gabimeve të veta?
  - Si përballen ata me problemet dhe dështimet?
  - A kanë ata vetëbesim të mjaftueshëm për të marrë pjesë në diskutimet në klasë?
- 

Mundohuni t'i bindni nxënësit të dinë se si mund ta çmojnë punën e tyre. Le t'i vendosin në një dosje pjesët e punës së tyre më të mirë. Qëllimi është që të aktivizohet motivimi i brendshëm i nxënësve. Motivimi i brendshëm vjen nga brendia e personit dhe nuk varet nga ndonjë reagim i jashtëm si lavdërimi apo shpërblimi. Nxënësit motivohen në mënyrë të brendshme nëse ndihen mirë për veten e tyre. Të qenit i suksesshëm në një fushë mësimore mund të inkurajojë nxënësit që të marrin rreziqe në fusha të tjera dhe të provojnë gjëra të reja. Është detyra e mësuesit që të gjejë një fushë ku nxënësi është akademikisht i fortë dhe i suksesshëm. Vetëm kur nxënësit janë në gjendje të vlerësojnë përpjekjet e veta, ata do të jenë në gjendje të mbështeten në vlerat e veta dhe jo në gjykimet e jashtme.

Përzhvillimin konceptit për veten nga ana e nxënësve është jashtëzakonisht e rëndësishme që ata të ndihen të pranuar nga mësuesit dhe kolegët. Mësuesit duhet të përpiqen t'u mësojnë nxënësve se nuk është e thënë t'i pëlqejnë të gjithë, dhe se është e rëndësishme që të pranojnë të tjerët dhe të pranohen nga të tjerët.

## 2.2 Shkathtësitë për jetën

---

### Detyrë:

1. Lexoni tekstin në faqen në vijim.
  2. Mendoni për një klasë në të cilën mbani mësim.
  3. Plotësoni tabelën me metrin e shkathtësive për jetën.
  4. Ku shënojnë rezultate të mira nxënësit tuaj? Ku kanë ende nevojë për shumë përmirësim ata, sipas mendimit tuaj?
  5. Tregojuni metrin e kompletuar të shkathtësive për jetën së paku dy kolegëve tuaj dhe diskutoni për të.
- 

Shkathtësitë për jetën si fjalë kyçe të përdorura në FACE i referohen përkufizimit në vijim të paraqitur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh): "Shkathtësitë për jetën janë aftësitë për sjelljen e përshtatshme që u mundësojnë individëve të përballojnë me efikasitet kërkesat dhe sfidat e jetës së përditshme" (Organizata Botërore e Shëndetësisë, 2001). OBSh përshkruan 10 shkathtësi thelbësore:

- Marrja e vendimit
- Zgjidhja e problemeve
- Të menduarit kreativ
- Të menduarit kritik
- Komunikimi efektiv
- Marrëdhëniet ndërpersonale
- Vetëndërgjegjësimi
- Ndjeshmëria
- Përballja me emocionet
- Përballja me stresin

Pra, shkathtësitë për jetën mund të përcaktohen si kompetenca që i duhen një individi për të jetuar dhe pasuruar jetën e vet. Materialet që mbështesin zhvillimin e këtyre shkathtësive duhet të ndërlidhen me këto kompetenca dhe të kontribuojnë në shpërfaqjen e nivelit ekzistues të kompetencave, duke i transferuar dhe duke i vënë në përdorim ato për mbështetjen e shkathtësive jetësore në kontekstin shkollor. Për të kuptuar më hollësisht, materiali i zhvilluar në projektin FACE flet për kompetencat vetanake të ndara në fusha të ndryshme për vlerësim më të mirë (shihni prapë përshkrimin e kompetencave në kapitullin 1).



## 2.3 Shpërfaqja e kompetencave ekzistuese

---

### **Detyrë:**

1. **Lexoni tekstin në heshtje.**
  2. **Mendoni për kompetencat ekzistuese në klasën ku mbani mësim.**
  3. **Çfarë janë ato? A mund t'i shënoni ato?**
  4. **Krahasoni ato me listën e kolegëve tuaj. A keni ngjashmëri?**
- 

Fëmijët dhe adoleshentët që u përkasin pakicave apo grupeve të lëndueshme brenda shoqërisë shpesh janë jo vetëm të pafavorizuar për shkak të prejardhjeve të tyre etnike dhe dallimeve nga shumica, por edhe për shkak të qasjes së kufizuar dhe vijimit të kufizuar të shkollës (UNICEF 2007).

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se këta fëmijë e fillojnë shkollën si "tabula rasa" pa kompetenca dhe shkathtësi të fituara më parë. Përkundrazi, fëmijët që rriten në situata të vështira socio-ekonomike shpesh duhet t'i kontribuojnë mbijetesës së familjes së tyre. Në rastin e fëmijëve romë, ky fenomen është i pranishëm kur vëzhgojmë fëmijët në shkolla. Këta fëmijë hyjnë në shkollë me kompetenca dhe shkathtësi që ata kanë fituar në mjediset e edukimit joformal, në familjet e tyre, në grupin e tyre të bashkëmoshatarëve, në rrugë, etj. Është shpesh sistemi arsimor, jo vetëm në vendet e Evropës Juglindore, por edhe në shumicën e vendeve në Perëndim dhe në Veri, që nuk arrin të perceptojë, matë dhe vlerësojë këto kompetenca ekzistuese. Shkollat nuk ofrojnë mundësi që këto kompetenca dhe aftësi ekzistuese të mund të zbatohen, të dëshmohen, të zhvillohen më tutje dhe të transferohen në mënyrë të tillë që të bëhen të dobishme dhe të pranuar nga institucioni dhe kërkesat e tij.


Këto kompetenca ekzistuese shpesh përfshijnë shkathtësitë e përshkruara për jetën, siç janë marrja e vendimeve, zgjidhja e problemeve, të menduarit krijues, komunikimi efektiv, përballja me emocionet dhe stresin, etj. Por ato gjithashtu përfshijnë kompetenca thjesht të lidhura me lëndët siç janë llogaritja, shkathtësitë e komunikimit verbal (sidomos kur fëmijët janë në rolin e shitjes së gjërave), shkathtësitë teknike (riparimi, puna bujqësore, artizanati), si dhe njohuritë rreth mjedisit të tyre dhe materialeve të tij (puna bujqësore, parashikimet e motit etj) apo shkathtësitë artistike/muzikore (për shkak të trashëgimisë së pasur kulturore). Në shkolla, fëmijët me kompetenca të tilla ekzistuese ose të fituara më parë, nuk mund t'i tregojnë dhe t'i provojnë pasi që vështirë kërkohen ndonjëherë si detyra shkollore, teste ose forma të tjera të procedurave të vlerësimit përmbledhës. Kjo është gjithashtu arsyeja pse fëmijët romë kur vendosen në grupe të përziera me fëmijë joromë, shpejt bëhen të stigmatizuar dhe mbeten të huaj. Mungesa e perceptuar e aftësive të tyre njohëse bëhet e dukshme në kontekstin e klasës për mësuesit dhe kolegët e tyre. Në kontekste të tjera, këta fëmijë do të shiheshin ndryshe.

Programi FACE përpiket t'i bëjë këto kompetenca dhe shkathtësi më të dukshme për të dyja grupet: fëmijët dhe familjet rome, si dhe familjet dhe fëmijët joromë në klasë. Vetëm kur të

dyja grupet dhe vetë shkolla fillojnë t'i shohin dhe t'i vlerësojnë shkathtësitë dhe kompetencat që janë fituar diku tjetër, mund të përdoret potenciali i tyre dhe mund të krijohen mundësitë e të nxënit në klasë, ku këto shkathtësi mund të transferohen në kompetenca, shkathtësi dhe strategji të dobishme për kontekstin specifik të të mësuarit në shkollë.

**Kompetencat ekzistuese në njërën klasë timen:**

Shembuj: aritmetika mendore, gatimi, organizimi, kujdesi për fëmijët, artizanatet, riparimi, punët e artit, muzika, etj.

$$7 + 4 = ?$$





## 3 PRAPAVIJA PEDAGOGJIKE

### 3.1 Një perspektivë drejt mësimdhënies dhe të nxënit

#### Detyrë:

1. Kur mendoni për të kuptuarit tuaj për mësimdhënien dhe të nxënit, cilat janë elementet më të rëndësishme për ju? Bëni një stuhi mendimesh me kolegun apo kolegen tuaj. Mbani shënime në një fletë.
2. Lexoni artikullin në faqen tjetër.
3. Diskutoni atë me të njëjtin koleg apo kolege. Cilat mendime vendimtare mund t'i nxjerrni nga ky artikull?

#### Arsimimi me nxënësin në qendër

Mësimdhënia dhe të nxënit në shkollat shumëkulturore dhe shumetnike që duan të mbështesin shkathtësitë për jetën dhe kompetencat vetanake të nxënësve duhet të jenë me nxënësin në qendër. Kjo qasje bazohet në supozimin se struktura, zgjedhja e përmbajtjes dhe organizimi i të gjithë mësimdhënies duhet t'u përshtaten nevojave të nxënësve. Mësimdhënia me nxënësin në qendër nënkupton që fokusi i vëmendjes është në individualitetin e nxënësit, p.sh. nxënësit perceptohen si individë me një personalitet të pavarur (Helmke, 2012). Në arsimimin me nxënësin në qendër, nxënësit merren seriozisht dhe vlerësohen si individë, pavarësisht nga performanca e tyre mësimore apo suksesi. Kjo do të thotë që interesat, biografia dhe prejardhja, kushtet e jetesës (gjendja jetësore) dhe nevojat specifike të nxënësve perceptohen dhe respektohen. E gjithë kjo ka efekt pozitiv në vetëvlerësimin dhe nxitjen e motivimit të nxënësve, dhe në të njëjtën kohë në marrëdhënien nxënës-mësues. Nxënësit në arsimimin me nxënësin në qendër ndihen të lehtësuar dhe merren më seriozisht si njerëz. Sigurisht, ky lloj mjedisi nënkupton që nxënësit mund t'i drejtohen mësuesit jo vetëm për çështje të lidhura me mësimin, por edhe për çështje apo probleme personale. Në këtë kontekst, arsimimi nënkupton jo vetëm shkollimin, por në shkallë të caktuar edhe prindërimin.

Përveç duke i kushtuar vëmendje dimensionit emocional dhe atij të ndjeshmërisë në planifikimin e mësimin, arsimimi me nxënësin në qendër merr gjithashtu parasysh

fazën zhvillimore të nxënësit, njohuritë e mëparshme, situatën fillestare, përvojën dhe kushtet e jetesës.

Fëmijët perceptohen si pjesëmarrës dhe subjekte aktive dhe jo si objekte të thjeshta të mësuesit apo të programit arsimor. Prandaj, kërkesa kyçe e arsimit me nxënësin në qendër është t'i stimulojë fëmijët dhe adoleshentët në mënyrë të plotë për t'u bërë aktivë. Si rezultat, ky koncept arsimor nuk e vendos mësuesin në qendër të mësimdhënies, por i vendos nxënësit. Mësimdhënia me nxënësin në qendër nënkupton planifikimin dhe strukturimin e një mësimi sipas këndvështrimit të nxënësve, në bashkëpunim me ta dhe në përputhje me nevojat e tyre (Wiater 2012). Ose, siç e thotë Helmke (2012): arsimimi me nxënësin në qendër karakterizohet nga një shkallë e lartë e pjesëmarrjes dhe aktivitetit të nxënësve. Në krahasim me arsimimin me mësuesin në qendër, model ky i praktikuar në shumicën e vendeve të Evropës Juglindore, arsimi me nxënësin në qendër kërkon një rol rrënjësisht të ndryshëm të mësuesit (shih seksionin mbi rolin e ri të mësuesit si lehtësues i të nxënësve).

### Qasja konstruktiviste

Në kontekstin e perspektivës së mësimdhënies dhe të nxënësve me nxënësin në qendër, të kuptuarit e të mësuarit si ndërtim individual është më se i rëndësishëm. Kjo qasje konstruktiviste në të nxënësve bazohet në dy supozime kyçe (shih Woolfolk 2008):

1. Fëmijët dhe adoleshentët janë subjekte aktive në procesin e të nxënësve të tyre dhe "ndërtojnë" vet njohuritë e tyre (bazuar në njohuritë e tyre të përditshme ata zhvillojnë, për shembull, idetë dhe "modele" e veta për ndryshimin mes ditës dhe natës, për luftërat apo për pabarazinë midis të pasurve dhe të varfërve).
2. Ndërveprimet shoqërore janë të rëndësishme për këtë proces të ndërtimit të njohurive.

Qasja konstruktive ndaj të nxënësve bazohet në supozimin se nxënësit kanë nevojë për mjedisin vetëm si stimul dhe kallëp për zhvillimin e tyre. Impulsi kryesor për të nxënësve vjen nga vetë nxënësit. Sipas kësaj pikëpamjeje, nxënësit janë në mënyrë aktive dhe specifike në kërkim të atyre gjërave në rrethinat e tyre që paraqesin problem ("Përse errësohet natën?", "Pse migruan kaq shumë njerëz nga vendi im?") në mënyrë që të rrisin njohuritë e tyre duke zgjidhur problemin. Të mësuarit shihet si një rirregullim i vazhdueshëm i njohurive. Struktura ekzistuese e ndërtuar nga vetë fëmijët dhe adoleshentët shtrihet me çdo proces dhe hap të ri të të mësuarit, apo riorganizohet ose ndërtohet nga e para.

Metodologjia konstruktiviste preferon ndërtimin dhe aplikimin e njohurive dhe kompetencave në memorizimin të thjeshtë, kujtimin dhe riprodhimin e fakteve, koncepteve dhe aftësive (Woolfolk 2008). Qëllimet e të mësuarit në qendër të metodologjisë konstruktive janë shkathtësitë për zgjidhjen e problemeve, të menduarit kritik, bërja e pyetjeve, vetëvendosja dhe të qenit i/e hapur për zgjidhje të ndryshme. Nga këndvështrimi konstruktivist, rekomandimet për arsimimin janë si në vijim:

- Të mësuarit duhet të bazohet në mjedise dhe çështje të ndërlikuara, realiste dhe relevante të të mësuarit; këto, me radhë, nxisin "ndërtimin e njohurive" dhe të "mësuarit zbulues" të nxënësve.
- Nxënësit duhet të mbështeten në pranimin dhe diskutimin e perspektivave të ndryshme. Që të jenë në gjendje ta bëjnë këtë, atyre duhet t'u ofrohen qasje të ndryshme për të njëjtën temë. Nxënësit, po ashtu, duhet ta kenë mundësinë për të diskutuar në mënyrë të drejtë dhe për të shkëmbyer ide.
- Nxënësit duhet të jenë të vetëdijshëm se janë përgjegjës për të mësuarit e tyre dhe cilësinë e tij (kjo do të thotë në të njëjtën kohë duke forcuar vetëdërgjegjësimin dhe të kuptuarit se të mësuarit është rezultat i procesit konstruktivist).

Kështu zvogëlohet rëndësia e transferimit të njohurive dhe të mësuarit të thjeshtë të fakteve, që karakterizon mësimdhënien tradicionale. Kjo gjithashtu kërkon që mësuesit e klasave shumëkulturore dhe shumëetnike ta rimendojnë planifikimin e detyrave të të mësuarit. Në vend të dhënies së detyrës "Mësoni përmendësh emrat e bimëve dhe kafshëve në vijim", detyra mund të duhet të riformulohet si: "Në grupe prej tre vetave, diskutoni se cilat bimë dhe kafshë luajnë rol të rëndësishëm në nivelet e ndryshme të pyllit, mbani shënime dhe krijoni një poster të vogël lidhur me këtë".

Një pjesë e qasjes konstruktiviste gjithashtu thekson dimensionin e rëndësishëm të mësimit të pavarur dhe autonom. Në këtë kontekst, termi kyç është "të mësuarit e vetëdrejtuar". Kjo do të thotë që nxënësit rregullojnë (drejtojnë) dhe përcjellin vetë (në mënyrë të pavarur/autonome) procesin dhe progresin e mësimit (duke përfshirë detyrat e shtëpisë dhe projektet afatgjata si prezantimi). Në këtë kuptim, të mësuarit e pavarur do të thotë se nxënësit janë përgjegjës dhe mund të vendosin në mënyrë autonome për aspekte të ndryshme të të mësuarit të tyre.

#### Këto vendime janë të lidhura në veçanti me dimensionet e mëposhtme:

<b>Qëllimet e të mësuarit:</b>	Çfarë më duhet apo çfarë dua të jem në gjendje të bëj?
<b>Përmbajtja e të mësuarit:</b>	Çfarë më duhet apo çfarë dua të di?
<b>Metodat e të mësuarit:</b>	Si e mësoj këtë, cilat metoda e strategji i shfytëzoj?
<b>Mjetet e të mësuarit:</b>	Çfarë mjetesh më duhen?
<b>Koha:</b>	Sa kohë më duhet apo kam në dispozicion?
<b>Ritmi i punës:</b>	Sa shpejt punoj?
<b>Partneri i të mësuarit:</b>	A të punoj vetëm? A të punoj me dikë tjetër? A të punoj në grup?

Ndërsa rezultatet e të nxënit dhe përmbajtja e mësimit (në realitetin e përditshëm) në shkollë zakonisht janë të fiksuara, nxënësit kanë disa zgjedhje në lidhje me kohën, ritmin, partnerët e të mësuarit dhe nganjëherë edhe metodat e mësimit që duan të përdorin. Programi FACE përdor nivele të ndryshme të të mësuarit të vetëdrejtuar në mënyrë që të udhëzojë mësuesit në vendimet e tyre se cili dimension duhet të hapet së pari dhe në mënyrë që të zbusë çdo frikë të kaosit që mësuesit shpesh e lidhin me një mësime plotësisht të "hapur". Strategjitë mësimore të përmendura më sipër janë shumë të rëndësishme në këtë drejtim. Ato përbëjnë bazën e cila u duhet nxënësve për të planifikuar, organizuar dhe kontrolluar/rregulluar të mësuarit e tyre në mënyrë të pavarur dhe autonome.

## 3.2 Të nxënit relevant për jetën

### Detyrë:


1. **Lexoni tekstin.**
2. **Kur mendoni për nxënësit tuaj, cilat tema do të ishin relevante për ta në aspektin e jetës së tyre? Shënoni ato në kolonën e parë të tabelës.**
3. **Tani shfletoni librin FACE. Cilat tema i konsideroni më së shumti relevante për jetën e tyre? Shënoni ato në kolonën e dytë.**

Çdo mësime duhet që gjatë zgjedhjes së përmbajtjeve mësimore të marrë në konsideratë jetën e përditshme të nxënësve dhe kushtet e ardhshme. Kjo bëhet edhe më e domosdoshme kur kemi të bëjmë me fëmijët dhe adoleshentët që kanë prejardhje socio-ekonomike të varfra ose që kanë një biografi shkollore të shkurtër dhe të pasuksesshme. Kjo do të thotë që temat duhet të zgjedhen ashtu që të jenë të përditësuar dhe relevante për jetën e nxënësve. 50 vjet më parë, Wolfgang Klafki e shprehu këtë në mënyrë të theksuar përmes pyetjes së mëposhtme: "Sa relevante është përmbajtja apo tema e caktuar në zhvillimin kognitiv të fëmijëve në klasën time? Ose në mënyrë më specifike, cilat përvoja apo shkathtësi mendohet të fitojnë ata, përmes kësaj përmbajtjeje apo teme? Sa relevante është përmbajtja nga këndvështrimi pedagogjik?" (Klafki, 1958). Pra, jo vetëm që duhet të merret parasysh rëndësia e përmbajtjes në aspektin e nevojave të tashme të nxënësve, por edhe në aspektin e së ardhmes së tyre.

Është punë e mësuesit që të zgjedhë përmbajtje mësimore relevante për jetën e tashme të nxënësve dhe për nevojat e tyre të ardhshme. Ofrimi i përmbajtjes mësimore relevante për jetën e nxënësve kërkon standarde të larta profesionale nga ana e mësuesve dhe informata të përditësuar për përditshmërinë, problemet dhe kushtet e nxënësve. Për mësuesit e grupeve shumëkulturore dhe shumetnike kjo do të thotë, para së gjithash, që ata duhet të marrin parasysh faktin se nxënësit e tyre rriten si fëmijë që i përkasin një pakice, si pjesë e dy kulturave dhe me përvoja që dallojnë në mënyrë të konsiderueshme nga përvojat e fëmijëve të tjerë në shkollë. Tema të tilla si "Jeta në qytet", "Përrallat dhe

mitet", "Pas 20 vjetëve unë do të jem...", "Puna që e ëndërroj" etj., në shkollat rurale në Rumani, Maqedoni apo Kosovë duhet të trajtohen ndryshe nga mënyra se si do të trajtohen në shkollimin e zakonshëm në mjedise urbane. Në rastin e fëmijëve të pakicave që rriten në një mjedis dykulturore, është e domosdoshme të kihet parasysh jo vetëm prejardhja e tyre dhe përvojat e kompetencat e tyre shtesë, por edhe zotërimi (zakonisht) më i dobët i gjuhës dhe kulturës së tyre të trashëguar. Pak vende kanë bërë përpjekje për të përshtatur kurrikulën e tyre në një mënyrë që trajton gjithashtu tema që janë relevante për jetën e fëmijëve romë. Pra, ende mbizotëron numri i temave që mësohen tradicionalisht.

Temat relevante për jetën, për nxënësit e mi	Detyrat relevante për jetën në FACE, për nxënësit e mi



### 3.3 Rolet e ndryshme të nxënësve dhe mësuesve

#### Detyrë:

1. Lexoni artikullin.
2. Analizoni rolin tuaj si mësues dhe rolet e nxënësve në klasën apo klasat tuaja.
3. Shkruani cilat role i merrni ju si mësues dhe cilat role i marrin nxënësit.
4. Sillni rezultatet tuaja tek i gjithë grupi.
5. Në cilat mënyra mendoni se mësimdhënia e FACE ndryshon rolet e mësuesit dhe të nxënësve. Cilat janë sfidat më të mëdha me të cilat ballafoheni?

#### Rëndësia e menaxhimit të klasës

Menaxhimi efektiv i klasës është një nga parakushtet për mësimdhënie të cilësisë së mirë. Menaxhimi i klasës është kornizë që përmban elementet kohore dhe ato motivuese për mësimdhënie në klasë; ndihmon në shmangien e shqetësimeve dhe kaosit të panevojshëm. Studimet ndërkombëtare kanë treguar se ekziston një lidhje e vërtetuar e drejtpërdrejtë ndërmjet menaxhimit të klasës dhe nivelit të progresit të të nxënësve. Në këtë kuptim, meta-analiza gjithëpërfshirëse e Hattie (2013) tregon në mënyrë të barabartë se klasat e organizuara mirë dhe mësuesit që janë të angazhuar fuqishëm në menaxhimin e klasës kanë efekt të qartë (të mesëm ose të lartë) mbi performancën e të mësuarit të nxënësve të tyre. Një aspekt tjetër i rëndësishëm është qëndrimi personal i mësimitdhënësve (motivimi, angazhimi) dhe shkalla në të cilën ata janë në gjendje ta njohin dhe të reagojnë ndaj sjelljes problematike të nxënësve. Pikat e mëposhtme janë thelbësore në lidhje me menaxhimin e klasës në klasat shumëkulturore dhe shumetnike (shih Woolfolk 2008):

- Klasa duhet të jetë mirë e organizuar (materiali, aranzhimi i uljes, aspektet organizative, etj.).
- Të gjithë nxënësit duhet të jenë shumë dhe në mënyrë të vazhdueshme të përfshirë në aktivitete dhe ushtrime që janë tërheqëse dhe të bazuara në detyra; si mësues duhet të jeni në gjendje t'i njihni dhe modifikoni aktivitetet si duhet.
- Përcaktoni, mundësisht së bashku me nxënësit, rregullat dhe sjelljet e qarta dhe bindëse dhe ofroni qasje të lehtë në to (p.sh. vendosni një poster me rregulla të klasës ose rregulla të komunikimit).
- Përcaktoni pasojat e sjelljes së papërshtatshme; merruni me problemet e disiplinës pa bërë bujë dhe pa ndërprerë mësimin.
- Një mësues mund të rrezatojë pasiguri dhe pavendosmëri.
- Sigurohuni që mësimet po rrjedhin pa probleme duke shmangur ndërprerjet e papërshtatshme dhe të panevojshme.

### Rolet e reja të mësuesit si lehtësues i të nxënimit

Për nxënësit, të nxënimit e orientuar në kompetenca dhe në nevoja do të thotë të jenë shumë aktivë. Që të ndodh kjo, mësuesi duhet të planifikojë aktivitete të përshtatshme të të nxënimit, t'i mbikëqyrë nxënësit përgjatë rrugës dhe t'u japë atyre mbështetje aktive nëse duhet. Gjithnjë e më shumë mësuesit po e marrin rolin e "lehtësuesit të të nxënimit", p.sh. të iniciatorit, mbështetësit apo vlerësuesit të proceseve të mësimore; ata e demonstrojnë rolin e tyre si ligjërues klasikë gjithnjë e më pak. Programi dhe materialet mësimore të FACE theksojnë këtë ndryshim në rolin e mësuesit.

Për të qenë në gjendje ta përmbushë këtë rol të ri, mësuesi duhet të jetë në gjendje t'i vlerësojë nevojat e të nxënimit dhe parakushtet e secilit nxënës. Detyrat tjera përfshijnë planifikimin e njëjësive mësimore sfiduese sa i përket përmbajtjes dhe metodologjisë, zhvillimin e rrugëve të të mësuarit, zgjedhjen e ushtrimeve, vëzhgimin dhe mbikëqyrjen e procesit të të nxënimit dhe, në qoftë se lindin probleme, ndërhyrjen në një mënyrë adekuate. Gjatë dhe në fund të një periudhe të të mësuarit është gjithashtu e nevojshme të analizohet sukcesi i të mësuarit (kush ka mësuar çfarë; cilat synime apo kompetenca duhet të theksohen më tej ose të shihen më thellë dhe nëse është i nevojshëm vlerësimi ose vënia e notave). Një aspekt tjetër i rëndësishëm është shkathtësia për të pasur një depërtim përmes bisedave me nxënësit, për të reflektuar mbi të nxënimit e tyre dhe për të regjistruar rezultatet. Ka mundësi të ndryshme në ditët e sotme, të tilla si mbajtja e një ditari të të mësuarit ose përpilimi i një dosjeje (portofoli) personale, në të cilin mbledhen disa produkte përfaqësuese të punës së nxënësve. Në kuadër të programit FACE, materialet e mësimdhënies dhe të të nxënimit grumbullohen në dosje dhe, kështu përbëjnë një ditar njëvjeçar të të mësuarit për nxënësit. Kjo gjithashtu do të thotë se marrëdhënia dhe bashkëpunimi ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve janë ndryshe p.sh. shumë më të barabarta dhe më intensive sesa në llojin tradicional të arsimit ku mësimdhënësit kryesisht ligjërojnë dhe ku autoriteti i tyre bazohet në pozitën e tyre zyrtare. Për disa mësues nga shtetet ku ekzistojnë më shumë modele të roleve tradicionale, mund të jetë një sfidë për t'iu përshtatur një kuptimi të ndryshëm të roleve dhe bashkëpunimit. Megjithatë, ata duhet të kuptojnë se nxënësit e tyre do të mësohen lehtësisht me këtë rol të ri të mësuesit.

### Rolet e mësuesit dhe nxënësve në klasën apo klasat e mia

Mësuesi	Nxënësit





## 4 METODAT DIDAKTIKE

### 4.1 Të nxënit e bazuar në detyra

#### Detyrë:

1. Lexoni tekstin.
2. Shfletoni librin FACE dhe gjeni tre shembuj të sekuencave të mësimdhënies dhe të nxënit të bazuar në detyra.
3. Diskutoni ata shembuj me kolegët.

Në FACE nxënësit mësojnë përmes metodave të të nxënit të bazuar në detyra. "I bazuar në detyra" e ka kuptimin që nxënësit janë ata që punojnë në detyra dhe jo mësimdhënësit. Kjo do të thotë që librat janë të dizajnuar në atë mënyrë që nxënësit të jenë në gjendje të zgjidhin problemet që çojnë në rezultate të dobishme dhe kuptimplota. Në procesin e zgjidhjes së këtyre detyrave, ata do të shqyrtojnë shumë rrugë që çojnë në një zgjidhje. Në këtë mënyrë nxënësit do të fitojnë kompetencat dhe shkathtësitë e nevojshme. Prandaj, duke punuar në një detyrë vetë do të thotë që nxënësit veç mësojnë diçka dhe është detyra juaj si mësues për ta bërë këtë të mundur. Mundohuni t'u jepni nxënësve lirinë për të provuar mënyra të ndryshme të zgjidhjes së një problemi: të nxënit e bazuar në detyra pastaj do të bëhet mjaft i thjeshtë! Gjithashtu mbani në mend këshillën e mëposhtme: "Pesë minuta është kufiri!"

Parimi i FACE është i bazuar në përqendrimin te nxënësit dhe aktiviteti i tyre gjatë mësimin. Për t'i lënë hapësirë të mjaftueshme të nxënit të bazuar në detyra është e domosdoshme për mësuesin që të jetë i vetëdijshëm për gjatësinë e kohës që flet. Mësuesi nuk duhet të tejkalojë kufirin e pesë minutave kur u jep udhëzime nxënësve.

Të nxënit të bazuar në detyra përqendrohet në kërkesën drejtuar nxënësve që të përfshihen në detyra kuptimplote që zhvillojnë kompetencën që mësuesi dëshiron ta arrijnë ata. Detyra të tilla mund të përfshijnë vizitën në ndonjë vend apo te ndonjë profesionist, realizimin e një interviste, apo thirrjen e shërbimit të konsumatorëve për ndihmë. Vlerësimi është i bazuar në radhë të parë në produktin e detyrës (me fjalë të tjera në kompletimin e duhur të detyrës) më shumë se në saktësinë e formave gjuhësore. Qasja themelore e integritit të të menduarit dhe të bërit ka implikime për gjithë procesin e të mësuarit. Trajtimi aktiv i objekteve mësimore nuk kufizohet vetëm në fazat paraprake të të nxënit "të

vërtetë", i cili kuptohet sikur përfshin vetëm mendjet e nxënësve. Më tepër, integrimi i të nxënësve dhe të vepruarit u jep të gjithë nxënësve një ide të qartë pse ata po mësojnë duke praktikuar: ata kanë një detyrë për ta kryer dhe kjo kërkon aktivizimin e shumë aftësive. Në këtë lloj të mësimdhënies, nxënësi duhet të përcaktojë nevojat e tij të të mësuarit në çdo situatë të re që lind. Nxënësit gjithashtu kërkojnë udhëzime nga mësimdhënësi dhe kjo do të thotë që nxënësit i përcaktojnë detyrat e mësimdhënësve dhe jo anasjelltas. Të nxënësve e bazuar në detyra prodhon kombinime ideale të të nxënësve konstruktivist dhe të nxënësve sipas udhëzimeve.

Sipas Rod Ellis në publikimin e tij: *Task-based Language Learning and Teaching*, Oxford Applied Linguistics: 2003 [Të nxënësve dhe mësimdhënësia e gjuhës e bazuar në detyra, Oxford Linguistikë Aplikative: 2003], një detyrë ka katër karakteristika kryesore:

- Detyra e vë fokusin primar në të kuptuarit (pragmatik)
- Detyra ka një lloj "hendeku"
- Pjesëmarrësit zgjedhin burimet e nevojshme për të përfunduar detyrën
- Detyra ka një rezultat të definuar qartë

Në nxënësve e bazuar në detyra, nxënësit përballen me probleme që ata dëshirojnë të zgjidhin. Të nxënësve nuk është një qëllim në vetvete, por çon në diçka të dobishme dhe kuptimplote. Nxënësit mësojnë duke shqyrtuar mënyrat për të zgjidhur një problem, duke i vënë vetes dhe mësuesit të tyre detyra që hapin rrugën drejt zgjidhjes së problemit. Shumë situata të jetës reale kanë të bëjnë me gjetjen e zgjidhjeve për problemet. Të nxënësve e bazuar në detyra i përgatit nxënësit për jetën duke krijuar situata reale të jetës si një mjedis për të nxënë.

Të nxënësve e bazuar në detyra ndjek një model që mund të përshkruhet në terma të përgjithshëm. Nëse mësuesi i përmbahet këtij modeli, potencialet e të nxënësve duke praktikuar (të tilla si të nxënësve aktiv) do të shpalosen pothuajse vetvetiu:

- Nxënësit ballafaqohen me një detyrë që duhet të zgjidhet (që prezantohet nga mësuesi apo në tekstin shkollor)
- Nxënësit planifikojnë veprimin e tyre
- Nxënësit zbatojnë planin e tyre të veprimit
- Nxënësit reflektojnë procesin e tyre të të nxënësve dhe i prezantojnë rezultatet e tyre

Është e rëndësishme që nxënësit të përjetojnë parimet e të nxënësve të bazuar në detyra, shpesh, në kontekste të ndryshme. Një detyrë e mirë që krijon shumë probleme që duhet të zgjidhen është mjeti më i mirë për të krijuar një mjedis produktiv dhe emocionues të të nxënësve.

Edhe pse ka një interes në rritje për të nxënësve e bazuar në detyra në mbarë botën, ka çështje që duhet të merren parasysh në planifikimin e metodologjisë rreth tij. Këto përfshijnë rrezikun që nxënësit të qëndrojnë brenda kornizave të sigurta të termave dhe formave të njohura, vetëm "sa për ta bërë", në mënyrë që të shmangen përpjekjet shitesë,

frika nga gabimet dhe rreziqet e të provuarit të mundësive të reja. Ashtu si me të gjitha punët grupore dhe detyrat grupore, disa nxënës mund edhe të mbështeten tek të tjerët për të bërë pjesën më të madhe të punës dhe të të nxënës.

Një sfidë tjetër është se nëse mësimi nuk është i planifikuar mirë, ekziston një rrezik i vazhdueshëm i pamjaftueshmërisë së kohës që të mësuarit e ri të arrihet dhe të përforcohet derisa është ende i freskët. Një sfidë e tretë është vështirësia e zbatimit të qasjeve të bazuara në detyra, aty ku klasat janë të mëdha dhe hapësira e kufizuar dhe/ose e papërshtatshme.

## 4.2 Të nxënës bashkëpunues

### Detyrë:

1. FACE përfshin shumë sekuenca të të mësuarit në bashkëpunim.
2. Shikoni librin FACE dhe identifikoni dy sekuenca të të nxënës në bashkëpunim.
3. Lexoni ato dhe diskutoni me kolegët.
4. Shkruani pyetjet që keni dhe sillni në grup.

FACE mbështet dhe inkurajon konceptin e të nxënës bashkëpunues. Të nxënës bashkëpunues përqendrohet në krijimin e një atmosfere të hapur kur punohet së bashku, në komunikim dhe në diskutim. Kur punohet së bashku, përmbajtja e detyrave mund të kuptohet më thellë dhe nxënës mund të zhvillojnë vetëbesim më të madh. Kur punojnë në grupe, nxënës përjetojnë ndjenjën e të qenit të pranuar nga të tjerët dhe të vlerësuar si anëtarë të ekipit dhe mund ta ndajnë njohurinë e tyre më lirshëm. Bashkëpunimi mund të inkurajohet nga lojërat grupore, aktivitetet grupore dhe diskutimet grupore. Mësimdhënës duhet të kujdesen për të ofruar periudha të punës individuale dhe periudha të punës në grup në një raport të balancuar.

Kjo formë e mësimdhënies nuk ka të bëjë thjesht me të lënit e nxënësve të punojnë në grupe me shpresën se puna do të bëhet disi. Ajo nuk duhet të shihet si një proces mësimi i cili në ndonjë formë është tkurrur në fushën e të nxënës shoqëror për shkak të mungesës së suksesit njohës të dukshëm. Përkundrazi, të mësuarit bashkëpunues ka të bëjë me arritjen e nxënësve. Shpërndarja e qartë e roleve midis anëtarëve të grupit është një parakusht për mësimdhënie të suksesshme sipas një modeli bashkëpunues. Në këtë mënyrë, detyrat formale që ofrojnë status të barabartë midis anëtarëve shpërndahen dhe praktikohen dhe kjo çon në të mësuarit e suksesshëm. Megjithatë, është e qartë se jo çdo detyrë është e përshtatshme për këtë lloj mësimi, dhe për këtë arsye nuk është ideja që të krijohet marrëdhënie e polarizuar midis formave të të mësuarit bashkëpunues dhe mësimdhënies së përqendruar në mësimdhënës. Në këtë model të mësimdhënies, mësuesi luan një rol të qartë dhe kuptimplotë. Sikur kanë treguar shumë krahasime të klasave, sukcesi i të mësuarit bashkëpunues varet nga disa elemente bazë. Procedura e mëposhtme duket se është provuar dhe testuar nga shumë mësues:

**Të mësuarit bashkëpunues – Si të organizohet një grup:****1. Emrat e anëtarëve të grupit renditen sipas alfabetit****2. Secilit anëtar të grupit i caktohet njëri nga rolet në vijim.**

Moderatori:	Ky person siguron që të gjithë anëtarët e kanë kuptuar detyrën dhe vepron si folës i grupit.
Raportuesi:	Ky person organizon prezantimin apo produktin përfundimtar.
Menaxhuesi i materialeve:	Ky person siguron që të gjitha materialet e nevojshme janë në dispozicion dhe kujdeset që gjithçka të jetë pastruar në fund.
Planifikuesi:	Ky person siguron që grupi e menaxhon kohën mirë dhe kontrollon nëse grupi po i përmbahet orarit. Ky person siguron që grupi planifikon kursin e veprimit në mënyrë të arsyeshme në fillim të detyrës dhe adapton këtë plan si duhet.
Ndërmjetësuesi:	Ky person zgjidh çfarëdo problem brenda grupit.

**3. Rregullat:**

- A Disa anëtarë të grupit kanë detyra/role të veçanta, por secili person është përgjegjës për gjithë procesin dhe rezultatet e grupit.
- B Nëse një pyetje duhet t'i bëhet mësuesit apo udhëheqësit të nxënësve, i gjithë grupi duhet të vendosë se si do të bëhet kjo pyetje. Në këtë mënyrë, grupi vendos për pyetjen së bashku. Udhëheqësit nuk përgjigjen në asnjë pyetje individuale gjatë procesit grupor.
- C Secili grup është përgjegjës për prezantim. Secili anëtar i grupit është përgjegjës për t'u përgjigjur në çfarëdo pyetje.

Mësuesit që shpesh punojnë me metodën grupore përmendin se shpesh ka kuptim që nxënësit të mbajnë rolet e tyre për periudha më të gjata kohore. Kjo ofron siguri, përshpejton të mësuarit dhe përmirëson performancën në grup.

## 4.3 Orientimi në qëllim

### Detyrë:

1. Lexoni tekstin.
2. Nënvizoni dy aspektet më të rëndësishme sipas këndvështrimit tuaj.
3. Shkëmbeni përvojën tuaj me një koleg apo kolege dhe diskutoni se çfarë mund të thotë orientimi në qëllim në klasat tuaja.

### Komunikimi i qëllimeve

Çdo libër, çdo ditë dhe çdo detyrë në programin FACE përfshin përshkrimin e qëllimeve që duhet të arrihen përmes të mësuarit të bazuar në detyra. Kur të shpjegohet një detyrë dhe jepen udhëzime me gojë për nxënësit, do të jetë ende shumë e rëndësishme të komunikohen objektivat. Vetëm atëherë nxënësit do të kuptojnë pse po e bëjnë atë që po e bëjnë.

### Zbatimi në klasë i teorisë së orientimit kah qëllimi

Nxënësit priren të miratojnë orientimet e qëllimit që theksohen në klasat e tyre. Duke qenë se hulumtimi tregon qartë se qasja zotëruese e orientimeve kah qëllimet lidhet me rezultate më të mira motivuese dhe kognitive, sugjerimet e mëposhtme duhet të ndihmojnë në përvetësimin e qëllimeve zotëruese:

1. Fokusohuni në të gjitha aspektet kuptimplota të aktiviteteve të të mësuarit.
2. Disenjoni detyra për risi, llojshmëri dhe interes.
3. Disenjoni detyra që janë sfiduese por të arsyeshme sa i përket kapacitetit të nxënësve.
4. Ofroni mundësi për nxënësit që të kenë ca zgjedhje dhe kontroll mbi aktivitetet në klasë.
5. Fokusohuni në përmirësimin individual, të mësuarit, progresin dhe zotërimin.
6. Përpquni ta bëni vlerësimin privat, jo publik.
7. Pranoni përpjekjen e nxënësit.
8. Ndihmoni nxënësit t'i shohin gabimet si mundësi për të mësuar.
9. Përdorni grupe heterogjene bashkëpunimi për të nxitur ndërveprimin ndërmjet moshatarëve; përdorni punën individuale për të përçaruar progresin.
10. Përshtatni kohën për dhënien e detyrave për nxënësit që kanë vështirësi të përfundojnë punën; lejoni nxënësit të planifikojnë orarin e punës dhe rrjedhën për progres.

Marrë nga (Schunk/Pintrich [2010]: Applying goal orientation theory in the classroom [Zbatimi në klasë i teorisë së orientimit kah qëllimet]. MeecePearson Allyn Bacon Prentice Hall. Në internet <http://www.education.com/reference/article/applying-goal-orientation-theory-classroom/> [20.06.2013]).

### Vendosja e qëllimeve, komunikimi i tyre dhe festimi i suksesit

Ndoshta, çështja më themelore që një mësues mund të marrë parasysh është çfarë do të bëjë për të vendosur dhe komunikuar qëllimet e mësimit, për të ndjekur përparimin e nxënësve dhe për të festuar suksesin. Në të vërtetë, kjo përfshin tri elemente të dallueshme por shumë të lidhura: (1) përcaktimi dhe komunikimi i qëllimeve të të nxënësve, (2) përcjellja e progresit të nxënësve, dhe (3) festimi i suksesit. Këto elemente kanë një marrëdhënie mjaft të drejtpërdrejtë. Vendosja dhe komunikimi i qëllimeve të të nxënësve është pika e fillimit. Tek e fundit, që të nxënësve të jetë efektiv, duhet të vihen caqe të qarta sa i përket informacionit dhe aftësisë. Sidoqoftë, vetëm krijimi dhe komunikimi i qëllimeve të të nxënësve nuk mjafton për të mësuarit e nxënësve. Përkundrazi, pasi të jenë vendosur qëllimet është e natyrshme dhe e domosdoshme për të ndjekur progresin e nxënësve. Ky vlerësim nuk ndodh vetëm në fund të një njësie mësimore, por përgjatë njësisë, përderisa punohet me të. Së fundi, duke pasur parasysh se çdo nxënës ka bërë përparim në një ose më shumë qëllime të të nxënësve, mësuesi dhe nxënësit mund t'i festojnë ato suksese.

## 4.4 Diferencimi dhe llojshmëria e detyrave

### Detyrë:

1. Lexoni tekstin.
2. Mendoni për një klasë në të cilën jepni mësim tash. Sa nivele të ndryshme të të nxënësve ka aty?
3. Shikoni librin FACE. Zgjedhni një detyrë që ju do ta përshtatni për tri nivele të ndryshme të të nxënësve.
4. Diskutoni idetë tuaja me një koleg apo kolege.

### Çfarë është diferencimi?

Mësimdhënia e diferencuar është thjesht ofrimi i udhëzimeve në mënyra të ndryshme për t'i adresuar nevojat e nxënësve të ndryshëm.

#### 1. Një klasë e diferencuar është proaktive

Mësimdhënësi në një klasë të diferencuar kupton që nxënësit individualë kanë nevoja të ndryshme. Për shkak të kësaj, mësuesi planifikon në mënyrë proaktive një shumëllojshmëri metodash për t'i nxitur nxënësit të angazhohen në të mësuar. Derisa një mësim tradicional ndryshon në mënyrë reaktive kur mësimi nuk po ndodh siç është planifikuar, një mësim i diferencuar planifikohet në mënyrë proaktive në mënyrë që nevojat individuale të adresohen para se mësimi të ndodhë.

#### 2. Mësimdhënia e diferencuar është më shumë cilësore sesa sasiore

Mësimdhënia e diferencuar nuk është sasia e punës që u jepet nxënësve, por më

shumë të vënit e nxënësve në një mjedis mësimi ku nxënësit mund të arrijnë të mësuarit. Për shembull, një nxënësi i cili tashmë ka zotëruar një koncept në matematikë nuk duhet t'i jepen më shumë probleme, por duhet të ndalojë së praktikuari atë shkathtësi dhe të kalojë në një shkathtësi tjetër. Përveç kësaj, të dhënit e një numri të vogël shembujsh një nxënësi që ka vështirësi është më pak efektive. Ky nxënës mund të ketë nevojë për më shumë ndihmë, praktikë ose një mënyrë alternative për të shprehur dijen.

### 3. Mësimdhënia e diferencuar ofron qasje të shumëfishta ndaj përmbajtjes, procesit dhe produktit.

Gjatë mësimdhënies, mësuesit janë të ndërgjegjshëm për tri elemente: përmbajtjen (çfarë mësojnë nxënësit), procesin (si e krijojnë nxënësit kuptimin e përmbajtjes) dhe produktin (si tregojnë nxënësit atë që kanë mësuar). Kur përdorin një qasje të diferencuar në klasë, mësuesit mund të ofrojnë qasje të ndryshme për atë që nxënësit mësojnë, si e mësojnë dhe si e demonstrojnë atë që kanë mësuar.

### 4. Mësimdhënia e diferencuar është me nxënësin në qendër

Një klasë e diferencuar është ajo që e lejon nxënësin të mendojë për veten e tij. Mësuesi nuk u tregon nxënësve gjithçka, por më tepër i lejon nxënësit të zbulojnë konceptet në mënyrë të pavarur dhe sipas ritmit të tij ose të saj. Mësimet janë të dizajnuara për të nxitur zhvillim tek të gjithë nxënësit. Mësimet nuk janë as shumë të vështira dhe as shumë të lehta për nxënësin individual, por sfiduese.

### 5. Mësimdhënia e diferencuar është një përzierje e të mësuarit me tërë klasën, të mësuarit grupor dhe të mësuarit individual.

Në një klasë të diferencuar, nxënësit marrin si lloje mësimore: të mësuarit me klasën e tërë, me grupin, dhe të mësuarit individual. Kur punohet së bashku me këto lloje të mësimdhënies, si tërësi e rrisin të nxënët e nxënësve. Gjatë të mësuarit me tërë klasën, nxënësit fitojnë ndjenjën e përkatësisë në komunitet dhe të kuptuarit të përbashkët. Pas të mësuarit me tërë klasën, nxënësit mund të lëvizin në punë grupore ose individuale dhe të përfundojnë duke ndarë atë që kanë mësuar në tërë klasën, sërish.

Adaptuar nga: How To Differentiate Instruction In Mixed- Ability Classrooms – Tomlinson 2001. (në internet: [http://legacy.mckinneyisd.net/departments/curriculum/MISD/Secondary/differentiation\\_in\\_the\\_classroom.htm](http://legacy.mckinneyisd.net/departments/curriculum/MISD/Secondary/differentiation_in_the_classroom.htm) [20.06.2013])

## Parimet kryesore të një klase të diferencuar

Diferencimi është një koncept i mësimdhënies në të cilin mësuesi i klasës planifikon për nevojat e ndryshme të nxënësve. Mësimdhënësi duhet të marrë në konsideratë dallimet e nxënësve siç janë:

- stilet e të mësuarit, nivelet e shkathtësive dhe notat
- shkathtësinë gjuhësore
- sfondin e përvojave dhe njohurive

- motivimin
- shkathtësinë për të marrë pjesë
- zhvillimin social dhe emocional
- nivelet e abstraksionit
- nevojat fizike

### **Parimet kryesore të një klase të diferencuar**

- Mësuesi është i qartë për atë që ka rëndësi në fushën e përmbajtjes
- Mësuesi kupton, vlerëson dhe ndërton mbi dallimet e nxënësve
- Vlerësimi dhe mësimdhënia janë të pandashme
- Mësuesi rregullon përmbajtjen, procesin dhe produktin në përgjigje të gatishmërisë, interesave dhe profileve të të mësuarit të nxënësve
- Të gjithë nxënësit marrin pjesë në punë të respektueshme
- Nxënësit dhe mësuesit janë bashkëpunëtorë në mësim
- Qëllimet janë rritja maksimale dhe sukcesi i vazhdueshëm
- Fleksibiliteti është shenjë dalluese e një klase të diferencuar

### **Në një program të diferencuar:**

- Dallimet merren si bazë për planifikim
- Dallimet e nxënësve e formësojnë kurrikulën
- Vlerësimi paraprak është normë
- Materiale të shumëfishta mësimore janë në dispozicion
- Ofrohen opsione të shumëfishta për nxënësit
- Nxënësit krijojnë kuptim nga informacioni
- Theksi vihet mbi konceptet dhe lidhjet
- Ka ritëm të ndryshëm
- Nxënësit marrin mbështetje në përcaktimin e qëllimeve dhe standardeve
- Përdoren kriteret e ndryshme të klasifikimit; respektohet përsosmëria si një përpyetje individuale

### **Një program i diferencuar nuk është:**

- "Mësimdhënie e individualizuar"
- "Kaotik"
- "Një mënyrë tjetër për të ofruar grupime homogjene"
- "Qepje e rrobave të njëjta"
- Më shumë detyra si mënyra të ndryshme të ofrimit të përvojave të të nxënësve



## 5 VLERËSIMI I PROCESVEVE MËSIMORE

### 5.1 Perspektivat e vlerësimit

#### Detyrë:

##### 1. Lexoni tekstin.

##### 2. Diskutoni me partnerin kuptimin e vetëpërceptimit:


- A Si i përjetoni fëmijët në klasën tuaj kur bëhet fjalë për vetëpërceptimin?
- B A provoni ndonjë ndryshim në perceptimin e mësuesit dhe prindërve kur bëhet fjalë për vlerësimin e përparimit të të nxëniet të fëmijëve?

Vlerësimet e brendshme dhe të jashtme i mundësojnë një personi të krijojë një ide për gjendjen e tij të të nxëniet dhe të zhvillojë hapa të mëtejshëm përgjatë rrugës. Të dyja llojet e vlerësimit ndihmojnë gjithashtu për të vendosur qëllime të reja.

Të gjithë njerëzit janë mësuar të vlerësohen nga njerëzit e tjerë. Kështu, njeriu merr informacion kthyes nga nxënësit, mësuesit ose prindërit.

Vetëvlerësimi përshkruan shkathtësinë për të vlerësuar vetveten dhe për të nxjerrë përfundimet prej tij. Është një instrument thelbësor për të mbështetur nxënësit në autonominë e tyre dhe për t'i udhëzuar se si të shkëputen nga varësia e pastër në komentet e mësuesve. Nxënësit që janë në gjendje të vlerësojnë veten realisht, zhvillojnë një pamje më të mirë të vetes së tyre dhe do të kenë më pak gjasa të ndihen të pasigurt. Ata do të jenë më pak të varur nga komentet dhe lavdërimet dhe mund të interpretojnë në mënyrë më adekuate reagimet e mësuesve.

Vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga të tjerët nuk duhet të jenë krejtësisht në harmoni, por duhet të dëgjohen në takime të përbashkëta, të mendohet për to dhe të diskutohen. Nxënësi nuk e sheh veten automatikisht në të njëjtën mënyrë si e sheh mësuesi. Pikëpamjet e ndryshme duhet të parashtrohen dhe diskutohen. Në këtë mënyrë mund të korrigjohen paqartësitë, perspektivat e ngushta ose konceptet e fiksuara. Hap pas hapi, nxënësit duhet të mësojnë se si të vlerësojnë kompetencat dhe shkathtësitë e tyre, si t'u japin informacion kthyes nxënësve të tjerë, si të pranojnë informacion kthyes dhe ta diskutojnë atë. Nëpërmjet kësaj qasjeje hap pas hapi, vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga të tjerët bëhen më të harmonizuara.



## 5.2 Format e vlerësimit

### Detyrë:

1. Lexoni për format e ndryshme të vlerësimit.
2. Mendoni se si ju e praktikoni vlerësimin e klasës suaj.
3. Cilat forma të vlerësimit përdorni? Përmbledhës? Formativ? Parashikues?
4. Mbani shënime për format e juaja të vlerësimit dhe diskutoni me një koleg apo kolege.

Në përgjithësi janë tri forma të ndryshme të vlerësimit:

### A Vlerësimi formativ: vlerësimi i proceseve mësimore

Kjo perspektivë shërben për ta përmirësuar, kontrolluar dhe verifikuar procesin e të nxënit të nxënësit, ose aktivitetet e nxënësit dhe mësuesit për të arritur një objektiv të caktuar.

### B Vlerësimi përmbledhës: vlerësimi i arritjeve mësimore

Në një moment të caktuar, një vlerësim përfundimtar përmbledh njohuritë dhe shkathhtësitë që ka fituar një nxënës. Qëllimi i tij kryesor është të informojë, për shembull, nxënësin ose prindërit për nivelin e performancës së nxënësit.

### C Vlerësimi parashikues

Ky lloj shikon në zhvillimin e ardhshëm të nxënësit. Në faza të ndryshme gjatë karrierës shkollore të nxënësve, njerëzit e përfshirë në procesin e arsimit të nxënësve (nxënësit, mësuesit, prindërit, në disa raste psikologët dhe autoritetet e shkollës) rekomandojnë si duhet të vazhdojë nxënësi karrierën e vet shkollore.

### Vlerësimi i proceseve mësimore: vlerësimi formativ

Qëllimi kryesor në vlerësimin e proceseve mësimore (ose vlerësimin formues) është të mbështesë nxënësin individual. Kështu përmirësohet efikasiteti i mësimdhënies. Në vend që të merren thjesht me simptomat, arsyet themelore për vështirësitë e të nxënësve hulumtohen dhe trajtohen (këto arsye mund të jenë si kognitive, ashtu edhe emocionale). Gabimet nuk korrigjohen por analizohen. Në këtë mënyrë idetë dhe mendësia e një nxënësi mund të kuptohen dhe mbështeten duke u orientuar në qëllim. Vështirësitë duhet të diskutohen së bashku me nxënësin dhe mund të trajtohen duke përdorur masa ose detyra të veçanta mbështetëse. Duke analizuar burimin e gabimeve të tyre, nxënësit nuk kanë nevojë të përshtaten në mënyrë sipërfaqësore dhe nuk ndihen se janë në mëshirën e vështirësive të tyre. Në vend të kësaj, ata mësojnë se si të zhvillojnë strategji individuale për t'u ballafaquar me problemet e veta.

Në këtë drejtim, të mësuarit e suksesshëm do të thotë që vazhdimisht të drejtohet procesi i të mësuarit dhe të punuarit në gabime nga të dyja palët, mësuesi dhe nxënësi; dhe jo thjesht të kërkuarit e metodave më të mira.

#### Mundësitë për të vlerësuar proceset mësimore:

- vëzhgimet
- detyrat e vogla, të përditshme
- testet pas një faze të gjatë pune

Testet që vlerësojnë proceset e mësimore veprojnë si një tregues për procesin e mësimdhënies dhe të nxënësve. Ato u mundësojnë nxënësve dhe mësuesve të kontrollojnë nivelin e arritjes. Zbrazëtitrat dhe pasiguritë mund të plotësohen me detyra shtesë.

#### Mundësitë për testim:

- vëzhgimi i nxënësve derisa zgjidhin një detyrë
- shikimi i saktë dhe analiza e detyrave të përfunduara
- biseda individuale mbi detyrat e përfunduara
- shtruarja e pyetjeve për mënyrën e zgjidhjes së një problemi
- testet e shkurtra

Nga vëzhgimet dhe bisedat rreth mënyrës se si nxënësit punojnë në detyra dhe rreth gabimeve të gabimeve të tyre, lindin synime individuale që nxënësit ia vënë vetes, që i vënë së bashku me mësuesin ose që mësuesi mund t'i vendosë për ta. Kur aplikohet ky lloj vlerësimi në mësimdhënien tonë, rrjedhoja logjike është gjithashtu një ndryshim drejt:

- të mësuarit e orientuar në qëllim në vend të të mësuarit të orientuar vetëm në përmbajtje
- mësimdhënies së individualizuar, në vend të mësimdhënies ku të gjithë punojnë në të njëjtën detyrë

### Vlerësimi i të arriturave mësimore: vlerësimi përmbledhës


Vlerësimi i arritjeve mësimore (ose vlerësimi përmbledhës) jep me pak fjalë një vlerësim të arritjes së nxënësit. Përmbledh të gjitha njohuritë dhe kompetencat e fituara. Ai shërben si një instrument për t'u ofruar informata prindërve, nxënësve dhe mësuesve. Ai gjithashtu mund të përbëjë bazën e mbështetjes së orientuar në qëllim. Këto lloje vlerësimesh përdoren pas periudhave të gjata të mësimdhënies dhe të nxënësve nëpërmjet vëzhgimit dhe testeve. Me to informohen adresuesit e ndryshëm se deri në çfarë shkalle nxënësit kanë arritur qëllimet e ndryshme. Shembuj të vlerësimit të të arriturave mësimore janë të gjitha llojet e testeve që kërkojnë njohuri të akumuluar të nxënësve ose kompetenca të një fushe/lënde të caktuar përgjatë një periudhe të caktuar kohore (për shembull, kuizet e demokracisë, testet e matematikës, testet e fjalorit, testet e studimeve shoqërore). Vlerësimi i arritjeve mësimore përdoret zakonisht në shkolla në të gjitha lëndët. Edhe pse është i domosdoshëm për notimin e nxënësve dhe për t'i dhënë mësuesit informata specifike rreth performancës së përgjithshme të nxënësve, vlerësimi përmbledhës sjell me vete probleme të ndryshme.

### Vlerësimi parashikues

Vlerësimet parashikuese shërbejnë si një mjet për përlogaritjen dhe parashikimin e karrierës së ardhshme të nxënësit. Vlerësimi parashikues kombinon aspektet bazë të marra nga një vlerësim i proceseve mësimore dhe një vlerësim i arritjeve mësimore dhe përpiqet të formulojë një diagnozë për të ardhmen e nxënësit. Ai bën pyetje të tilla si: "Si mund të mbështesim zhvillimin individual dhe proceset pozitive të të nxënësve?" Vlerësimet parashikuese bëhen shumë të rëndësishme në fazat e ndryshme të jetës akademike të nxënësit si:

- regjistrimi në shkollë
- përsëritja e vitit
- ndërrimi i klasave/shkollave
- transferimi në shkollë të llojit tjetër (për shembull, edukim special)
- transferimi në një shkollë të rangut më të lartë

Në këtë drejtim, gjatë dekadave të fundit, janë bërë diskutime në lidhje me çështjen nëse vlerësimi parashikues mund të përshkruhet me të vërtetë si një formë vlerësimi ose mund të konsiderohet si një funksion i vlerësimit.



## 5.3 Normat e vlerësimit

### Detyrë:

1. Lexoni tekstin.
2. Nënvizoni informatat më të rëndësishme.
3. Cilat janë normat e vlerësimit që përdoren në vendin, shkollën apo klasën tuaj?
4. Mbani shënime për t'u përgatitur për diskutim të përbashkët me kolegët tuaj.

Vlerësimi në shkollë është një fushë shumë e gjerë. Jo vetëm që ndikon në gjëra të qarta që mund të vëzhgohen, siç janë kualifikimet e nxënësve ose pozicioni i tyre në shoqëri (në varësi të notave të tyre) dhe kështu në karrierën e tyre akademike, por gjithashtu ndikon në aspekte të tjera brenda individit, si imazhi për veten, vetëvlerësimi dhe koncepti i përgjithshëm që nxënësi ka për kompetencat dhe shkathtësitë e veta. Shkolla ka një ndikim të madh në vetëperceptimin e kompetencave. Ndikimi i tij i drejtpërdrejtë varet nga mënyra e zgjedhjes dhe kryerjes së vlerësimit në shkollë.

### Kriteri social

Për shkak të kontekstit social (shoqëror) në të cilin zhvillohet mësimi në shkollë, përdorimi i kriterit social si një masë mund të japë informacion thelbësor në lidhje me kompetencat në krahasim me nxënësit e tjerë. Në të njëjtën kohë, vlerësimet për kompetencat në një perspektivë sociale krahasuese ndikojnë fuqishëm në imazhin dhe konceptin e nxënësve për veten.

### Kriteri individual

Përdorimi i kriterit individual për vlerësim nënkupton krahasimin e ndryshimet brenda-individuale me njëra-tjetrën. Cili është ndryshimi në mes të arritjes së nxënësit në FACE muajin e kaluar dhe tash? Është një krahasim i përkohshëm që përdoret këtu. Nxënësit e rinj në mënyrë të veçantë e preferojnë këtë kriter si një mjet për vlerësim. Sasia e "vlerës së shtuar" regjistrohet përgjatë një kohe të caktuar. Kjo bën të mundur që nxënësit t'i jepet informata kthyesë në lidhje me shtrirjen e arritjes së tij ose të saj, si dhe mënyrën në të cilën është rritur ose zvogëluar ajo. Arritja nuk krahasohet me arritjen e nxënësve të tjerë. Përkundrazi, përparimi i secilit nxënësi është në fokus. Kjo metodë e vlerësimit korrespondon gjithashtu me proceset e të mësuarit joformal që ndodhin jashtë shkollës, ku nxënësi vlerëson kompetencën e vet në mënyrë autonome.

### Kriteri objektiv

Arritja akademike krahasohet me objektivin mësimor. Një progres mësimor i arritur individualisht krahasohet me një qëllim realisht të arritshëm. Kjo metodë e vlerësimit është një normë e orientuar në objektiv dhe informon për qasjen ndaj një objektivi i

cili definohet si arritje e përsosur. Krahasimi i arritjeve të nxënësit me përparimin e të mësuarit të nxënësve të tjerë nuk është me rëndësi. Testet e bazuara në kritere janë të orientuara drejt objektivave të përcaktuara qartë. Ato masin arritjet duke iu referuar një karakteristike të caktuar të cilën e zgjedh mësuesi. Kjo gjithashtu do të thotë që mësuesi duhet t'i përcaktojë dhe paraqesë objektivat që nxënësit duhet të arrijnë. Kështu, arritjet e nxënësit nuk krahasohen me ato të nxënësve të tjerë. Sipas studimeve të ndryshme në këtë fushë, proceset shoqërore të krahasimeve ndërmjet nxënësve ndodhin vetëm kur nuk ekziston një kriter objektiv i përdorur në vlerësim.

Cilat janë rezultatet e këtij diskutimi? Nëse një mësues dëshiron të forcojë te nxënësit imazhin dhe konceptin për vete, vlerësimi duhet të ndodhë duke ndjekur kriterin objektiv. Objektivat e dhëna nga mësuesi duhet të jenë të qarta dhe duhet t'u komunikohen nxënësve.

## 5.4 Dhënia e informacionit kthyes nxënësit: nga ligjëruesi në lehtësues

---

### Detyrë:

1. Lexoni tekstin.
  2. Mendoni për mënyrën se si jepet informata kthyes në shkollë dhe për mënyrën se si ju u jepni informacionin kthyes nxënësve tuaj.
  3. Mendoni se çfarë do të thotë të ndërrohet roli i mësuesit.  
Çfarë do të ndryshojë për ju?
  4. Diskutoni të dyja pyetjet me një koleg apo kolege dhe formuloni 3 pyetje për t'i shtruar në diskutim plenar.
- 

Nxënësit në programin FACE janë të aftë të punojnë individualisht dhe, varësisht nga moshën e tyre, kuptojnë udhëzimet me shkrim ose mund të punojnë së bashku me shokët e shoqet. Sidoqoftë, detyra juaj si mësues do të jetë të siguroni mbështetje individuale për ata që kanë nevojë. Në rrjedhën e vitit shkollor të FACE, roli juaj do të zhvillohet gjithnjë e më shumë në drejtim të një lehtësuesi dhe ju do të shpenzoni më pak kohë si ligjërues.

Ose ju mund ta vini veten në rolin e këshilltarit duke ecur përreth dhe duke iu përgjigjur pyetjeve individuale ose mund t'ia caktoni këtë rol një nxënësi që tashmë ka përbushur detyrën. Sigurohuni që të mos zgjidhni gjithmonë nxënësit e njëjtë si shembuj për t'u ndjekur. Ata mund të bëhen të stigmatizuar dhe më pak të dashur për shokët e shoqet e tyre të klasës, nëse gjithnjë u caktohet ky rol.

## Dhënia direkte e informacionit kthyes

Rezultatet e studimeve të ndryshme kërkimore për faktorët që ndikojnë në arritjet e nxënësve tregojnë se faktori më i rëndësishëm është dhënia personale dhe e drejtpërdrejtë e informatës kthyes nga mësuesi. Gjatë programit FACE, sigurohuni që të rezervoni kohë të mjaftueshme për t'ua dhënë informatën kthyes nxënësve, jo vetëm në formë të shkruar, por edhe gjatë mësimave. Kur ta keni ndërruar rolin tuaj nga ligjëruesi në lehtësues, kjo do të ndodhë automatikisht. Ju do të njihni punën dhe performancën e nxënësve tuaj shumë më mirë sesa e keni bërë deri tash. Ju do të ndjekni përparimin e tij/saj shumë më afër dhe do të jeni në gjendje të komentoni punën e tij/saj individuale në një nivel shumë më të thellë. Ju gjithashtu do të duhet të merreni me shumë produkte të ndryshme në aspekt të cilësisë.

## Ideja e të shkëmbyerit

Kalimi nga roli i ligjëruesit në lehtësues nuk do të thotë që mësuesi humb rolin e paraqitjes së përmbajtjeve dhe fakteve. Megjithatë, roli i tij si moderator do të rritet dhe kjo përfshin nxitjen e proceseve të dëshiruara mësimore të nxënësit. Kjo lidhet veçanërisht me situatat ku duhet të zhvillohet një diskutim ose debat rreth diçkaje. Në librat e FACE, kjo gjithashtu përshkruhet si "diskutim" ose si "shkëmbim". "Shkëmbim" do të thotë të interesohesh për të tjerët, të dish se çfarë kanë arritur, se si e bënë atë, çfarë mendojnë, cilat janë arsyet e tyre, sikur se edhe shpjegimin rreth vetes, veprimet dhe arsyetimet, mendimet dhe përvojat e veta.

## Udhëheqja e diskutimit apo shkëmbimi

Kriteret e "udhëheqjes" së mirë përfshijnë aspektet në vijim:

- Nxënësit flasin më shumë sesa ju
- Nxënësit po ashtu shtrojnë pyetje, jo vetëm ju
- Kur ju shtroni pyetje apo i nxisni, më shumë se një apo dy nxënës përgjigjen
- Nxënësit i fillojnë pyetjet dhe përgjigjet në mes veti së paku një herë
- Shkëmbimi me të tjerët mbetet i fokusuar: ju (apo një nxënës) krahasoni, përmbliidhni, e riktheni diskutimin në pikën kryesore, etj.
- Personale dhe me gjallëri: ju (apo një nxënës) kërkoni të kundërtën, një opinion personal prej disa nxënësve, një shembull konkret, çfarë do të bënin ata jashtë shkollës, etj.
- Merr dhe jep mjaft kohë, ashtu që tri apo katër tema të mbulohen brenda një periudhe 15 minutëshe

## Të shkruarit e informacionit kthyes

Mos harroni të reagoni, në radhë të parë, në disa pika që ju interesojnë: çfarë ka bërë nxënësi mirë, ku ju befasoi, çfarë ishte pika kryesore në sytë tuaj. Pastaj mund të shtoni një pyetje për atë për të cilën dëshironi të dëgjoni më shumë, ose të jepni një këshillë konkrete se si nxënësi mund të veprojë ndryshe herën tjetër.

## 5.5 Dhënia e informacionit kthyes prindërve

### Detyrë:

1. Para se të lexoni tekstin, kujtoni një situatë pozitive dhe një negative ku u keni dhënë informacion kthyes prindërve.
2. Lexoni tekstin.
3. A pajtoheni me këto sugjerime? Cilat janë strategjitë tuaja personale për dhënien e informacionit kthyes prindërve? A mund të ndani diçka me kolegët tuaj?

"Djali juaj po ia del 'Ok'. Ai është mirë në lëndët akademike... vetëm vazhdoni kështu."

"Ajo e kupton mësimin."

"Ajo është miqësore me shokët e shoqet e klasës."

Komente të tilla si ato janë të rrezikshme dhe shumë të hapura për interpretime të ndryshme (p.sh. sa ok është "ok"?). Për prindin, kjo mund të nënkuptojë që nxënësi po performon përsosmërisht, kështu që çdo rënie e papritur në rezultatet e testimit të ardhshëm mund të shkaktojë stres dhe shqetësim. Mund të duket gjithashtu se mësimdhënësi nuk po i përcjell nxënësit. Për më tepër, është joreale dhe nuk ndihmon në zgjidhjen e ndonjë problemi në performancën akademike.

Mësuesit nuk mund dhe nuk duhet të shmangin takimet e rastësishme me prindërit, kur prindërit ka shumë të ngjarë të kërkojnë informata kthyes të menjëhershme. Ndonëse e pashmangshme, mësuesit mund të bëjnë disa gjëra për ta përgatitur veten në mënyrë që të ofrojnë informacion kthyes autentik.

1. **Mbledhni rregullisht informata të shkurtra.** Nëse keni një klasë të madhe, informatat duhet të jenë të pashtershme. Një listë kriteresh për mbledhjen e informatave përmes vëzhgimeve është thelbësore. Përqendrohuni në raste shumë të rëndësishme si p.sh: nxënësi nuk ishte në gjendje të përfundojë një detyrë apo rol në klasë, ai/ajo erdhi në shkollë pa detyrat e shtëpisë, tema për testet e dështuara dhe shpeshtësia e tyre, etj.
2. **Këshillohuni me mësuesit e tjerë në lidhje me informacionin kthyes të tyre,** veçanërisht nëse ju jeni kujdestar i klasës. Për ta arritur këtë në më pak se një orë, përqendrojeni takimin tuaj në performancën e vëzhguar dhe zgjidhjet e rekomanduara.
3. **Nëse shkolla juaj nuk ka një sistem të informacionit kthyes për prindërit, organizoni një të tillë bashkë me drejtorin tuaj dhe mësuesit tjerë.** Përcaktoni një orar të përshtatshëm në mënyrë që të mos rrezikoni detyrat dhe përgatitjen tuaj si mësues, gjithnjë duke pasur parasysh se jo të gjithë prindërit mund të jenë në dispozicion në çdo kohë të caktuar. Kur të jetë gati, lidhni sistemin e informacionit kthyes me prindërit, pasi ata janë pjesë e komunitetit të shkollës.



4. **Jepni informacion kthyes kur është i nevojshëm, edhe kur nuk është në orar.** Rastet e tilla si testet e njëpasnjëshme ku nxënësi mezi arrin të kalojë meritojnë një telefonatë për prindin. Mendoni këtë si një masë parandaluese nga ana juaj që mund të ndihmojë në shmangien e problemeve serioze akademike. Çdo prind me siguri do ta vlerësojë shqetësimin tuaj dhe reagimin me kohë.
5. **Organizoni shënimet tuaja.** Kjo do t'ju ndihmojë të ofroni raporte dhe rekomandime konkrete. Rendisni pikat në mënyrë prioritare. Disa gjëra nuk ia vlen të përmenden fare.
6. **Dëgjoni prindërit** dhe mbani shënime gjatë ose pas takimit për informata kthyes. Prindërit mund të përmendin ndodhi jashtë shkollës që mund të jenë me rëndësi për performancën e nxënësit në klasë. Meqë prindërit e njohin më gjatë nxënësin tuaj sesa ju, ata mund t'ju japin ndonjë ide se si ta motivoni më së miri fëmijën e tyre.
7. **Prindërit janë shokët tuaj të ekipit.** Me kontributin dhe njohuritë e tyre, qëllimi juaj përfundimtar është të krijoni zgjidhje që do të ndihmojnë më mirë në përmirësimin e performancës akademike të nxënësit dhe i ofrojnë mundësi për rritje personale.

Këta hapa të thjeshtë do t'i ndihmojnë mësuesit të shmangin raportet e paqarta për prindërit të cilët nganjëherë shërbejnë vetëm si shpresë e rreme. Klientët tanë meritojnë shërbimin më të mirë që mund t'u japim në aspektin e të qenit i saktë dhe në kohë.

Mësuesit që e komunikojnë performancën e nxënësve në mënyrë efektive janë në gjendje të ofrojnë ndihmë menjëherë duke njoftuar prindërit. Prindërit e informuar mirë, më pas janë në gjendje të ndërmarrin veprimin më të mirë korrigjues nga ana e tyre. Një veprim i tillë duhet të zhvillohet paralelisht me çfarëdo intervenimi që mësuesi bën në klasë. Prandaj nevojitet që mësuesit të jenë më të qartë dhe specifike në dhënien e informacionit kthyes.

Ashtu si çdo politikë e re apo ndryshim në politika, kjo do të funksionojë më së miri nëse formulohet si një komunitet. Mësuesit, administrata e shkollës dhe prindërit - që të gjithë duhet të kontribuojnë në krijimin dhe zbatimin e një sistemi efektiv të informacionit kthyes.

Marrë nga "The Learning Chronicle": Në internet: <https://thelearningchronicle.wordpress.com/2012/08/15/giving-feedback-to-parents-its-not-ok-to-just-say-ok/>





